



revive

NGA DHUNA TEK FUQIZIMI

**Doracak u shkurtër për punëtore dhe punëtorë
të strehimoreve dhe të shërbimeve publike**



Projekti i financuar nga BE menaxhuar
nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Implementuar nga:



Nga dhuna tek fuqizimi

**Doracak i shkurtër për punëtore dhe punëtorë
të strehimoreve dhe të shërbimeve publike**



**Riintegrimi i Viktimave të
Dhunës në Familje**

Me kontributin e



Nën kujdesin e
Agjencisë për Barazi Gjinore



Ky publikim është realizuar nga ana OJQ-së RTM - Vullnetarët nëpër botë, në bashkëpunim me Koalicionin e Strehimoreve të Kosovës (KSK) dhe me Koordinimin e Qendrave kundër dhunës nga Emilia Romagna (CCAER), si dhe nën kujdesin e Agjencisë për Barazi Gjinore të Kosovës (ABGJ).

Në role të ndryshme në hartimin e këtij doracaku kanë kontribuar:

- Virginia Venneri (RTM) – Vullnetare Junior në Kosovë
- Danila Zizi (RTM) – Koordinatore e Projektit REVIVE
- Francesco Gradari (RTM) – Përgjegjës për Projektet për rajonin e Ballkanit
- Naime Sherifi (KSK) – Kryesuese e Bordit KSK dhe Drejtoreshë e Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Prishtinë/ Priština.
- Ardita Ramizi Bala (KSK) – Drejtoreshë e Qendrës për Mirëqenien e Grave - Shtëpia e sigurtë në Pejë/Peć.
- Sakibe Doli (KSK) – Drejtoreshë e Shtëpisë së Sigurtë në Gjakovë/Đakovica.
- Nazife Jonuzi (KSK) – Drejtoreshë e Qendrës për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve “LIRIA” në Gjilan.
- Emine Kabashi (KSK) – Drejtoreshë e Qendrës për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës “RABA VOCA” në Mitrovicë/Mitrovica.
- Hamijet Dedolli (KSK) – Drejtoreshë e Qendrës për Mbrojtjen e Viktimave dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Prishtinë.
- Jubilea Kabashi (KSK) – Drejtoreshë e Qendrës për Mikpritjen e Grave dhe Fëmijëve në Prizren/Prizren.
- Alessandra Campani (CCAER) – Trajnuese dhe Këshilltare
- Elisa Bianchi (CCAER) - Trajnuese dhe Këshilltare

Ky doracak është i disponueshëm në
gjuhën shqipe, angleze dhe italiane.
Versioni elektronik i tij mund të shkarkohet
falas nga faqja e internetit:
www.reggioterzomondo.org

© RTM - Vullnetarët në Botë
(www.reggioterzomondo.org) - 2014

Shtypur në Prishtinë në Korrik 2014

DIZAJNI GRAFIK:
Arben Grajqevci
e-mail: arben.grajqevci@gmail.com

PËRKTHIMI:
Blerta Cerova
e-mail: blertacerova@gmail.com

Ky publikim u realizua me ndihmën e Bashkimit Evropian dhe të Regjionit Emilia Romagna. Përmbajtjet e këtij doracaku janë përgjegjësi e vetme e RTM, KSC dhe CCAER dhe nuk pasqyrojnë në asnjë mënyrë pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe të Regjionit Emilia Romagna.

*Ecën mbi gjethet që ende rrjedhin gjak
kësaj here vjen nga pylli
nga himne dhe heshtje
Nuk bie shi që të të mbulojë
Vjen për të folur
nën lëkurë mban vetminë
dhe dëshpërimin e gjakut
lumenjë e pyje ndjekin trupin tënd
për të të dhënë një jetë që nuk vdes.*

Gezim Hajdari

PËRMBAJTJA

***PREZANTIMET*9**

RTM - Vullnetarët në Botë11

KSK – Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës.....13

CCAER – Koordinimi i Qendrave
Kundër Dhunës në Emilia Romagna15

ABGJ - Agjencia për Barazi Gjinore.....17

Projekti REVIVE –
Riintegrimi i Viktimave të Dhunës në Familje.....19

***PARATHËNIE*.....22**

Dialogu dhe shkëmbimi midis Qendrave kundër Dhunës të
Kosovës dhe atyre në Emilia Romagna.

HYRJE	27
--------------------	-----------

PJESA E PARË

<i>Të dalësh nga dhuna</i>	31
---	-----------

1.1 Dinamikat dhe pengesat që hasin gratë që dalin nga marrëdhëniet e dhunshme.	31
1.2. Nga dhuna tek fuqizimi.	34
1.2.1 Qendrat kundër dhunës në Kosovë: origjina, misioni dhe zhvillimet.....	34
1.2.2 Funkzioni i qendrave kundër dhunës.....	36
1.2.3 Profesionalizmi dhe marrëdhëniet mes grave: parimet e ndërhyrjes mbështetëse	38
1.2.4 Procesi i fuqizimit.	39

PJESA E DYTË

<i>Praktikat e mira</i>	43
--------------------------------------	-----------

2.1. Rëndësia e praktikave të mira.	43
2.2. Praktikat e mira aktive në qendrat kundër dhunës të KSK.....	44
2.2.1. Procesi i pranimit të gruas në strehimore Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve “LIRIA” në Gjiilan/Gnjilane	46

2.2.2. Pavarësia personale: procesi i rehabilitimit të grave mysafire në strehimore <i>Qendra për Strehimin e Grave dhe Femijëve në Prizren/Prizren</i>	50
2.2.3. Pavarësia e punës: arritja e një jetese të pavarur nëpërmjet punës <i>Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Femijëve në Prishtinë/Priština</i>	54
2.2.4. Pavarësia e banimit: mbështetja ndaj gruas në procesin e riintegritit social <i>Shtëpia e Sigurtë në Gjakovë/Đakovica</i>	58
2.2.5. Proceset e punësimit të gruas <i>Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Femijëve “RABA VOCA” në Mitrovicë/Mitrovica</i>	62
2.2.6. Pavarësia ekonomike: procesi i orientimit ndaj punës dhe punësimit <i>Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimit të Trafikut të Qenieve Njerëzore në Prishtinë/Priština</i>	65
2.2.7. Monitorimi i gruas pas daljes nga strehimorja <i>Qendra për Mirëgenien e Grave – Shtëpia e Sigurtë në Pejë/Peć</i>	70
<i>Falënderime</i>	74
<i>Lista e shkurtesave dhe akronimeve</i>	75
<i>Bibliografia</i>	76

PREZANTIMET

RTM – VOLONTARI NEL MONDO VULLNETARËT NË BOTË



RTM është një OJQ e vullnetarizmit ndërkombëtar me frymëzim të krishterë e krijuar më 1973 me seli në Reggio Emilia. Misioni i RTM -së është që të promovojë dinjitetin e njeriut, mbrojtjen e të drejtave të tij themelore dhe të mbështesë proceset e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të komuniteteve duke respektuar mjedisin.

Në 40 vjet RTM ka realizuar programe të bashkëpunimit ndërkombëtar në Afrikë (Madagaskar, Republika e Afrikës Qëndrore), Evropën Lindore (Ukrainë), Ballkanin Perëndimor (Kosovë dhe Shqipëri), Amerikën Jugore (Brazil) dhe Lindjen e Mesme (Palestinë).

Ka 6 fusha kryesore dhe prioritare për RTM-në: zhvillimi rural, fuqizimi femëror, shëndetësia, tregtia e barabartë dhe solidarë, siguria ushqimore, edukimi parashkollor.

Në Kosovë, RTM është e pranishme dhe vepron në mënyrë të pandërprerë prej 1999-ës në 3 fusha: zhvillimi rural, të drejtat e grave, edukimi parashkollor. Në Kosovë dhe Shqipëri RTM i është përkushtuar aktualisht dy programeve të ndërhyrjes në fushën e zhvillimit bujqësor dhe në luftën kundër dhunës gjinore e familjare.

RTM vepron nëpërmjet programeve afatgjata në partneritet me institucionet publike, private dhe organizatat e shoqërisë civile me pjesëmarrjen aktive të akterëve të territorit të Emilia-s dhe Romagna-s (p.sh. universitete, autoritete lokale, kompani, shoqata) në mënyrë për të nxitur një shkëmbim mes komunitetëve, territoreve dhe ekspertëve.

Deri më sot, RTM ka realizuar 85 ndërhyrje të zhvillimit, prej të cilave 25 të financuara nga Ministria e Punëve të Jashtme Italiane dhe 29 nga Bashkimi Evropian, duke dërguar një total mbi 280 vullnetarë ndërkombëtarë në qëndrim afatgjatë.

Në Itali, RTM është angazhuar në aktivitete të informimit, ndërgjegjësimit dhe edukimit për zhvillimin e nënshtetësisë mbi tre tematika kryesore: të drejtat e grave, konsumi kritik dhe arsimimi global.

Kontakte

Në Itali

Adresa : Via Mogadiscio 1, 42124 Reggio Emilia (RE)

Tel./Fax: +39 0522 514205

E-mail: info@reggioterzomondo.org

Web: www.reggioterzomondo.org

Në Kosovë

Adresa : Rruga Abedin Rexha, 32000 Klinë, Kosovë

Tel./Fax: +381 (0)38733835

E-mail: rtnkosovo@gmail.com

KSC – KOSOVO SHELTER COALITION



Koalicioni i strehimoreve të Kosovës është një organizatë ombrellë e përbërë nga 8 shoqata të grave që ndajnë bashkërisht misionin e përkrahjes së grave dhe fëmijëve viktimave të dhunës dhe trafikimit.

Pjesë e KSK-së janë:

- *Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve “LIRIA” në Gjilan/Gnjilane*
- *Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve në Prizren/Prizren*
- *Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Prishtinë/Priština*
- *Shtëpia e Sigurtë në Gjakovë/Đakovica*
- *Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “RABA VOCA” në Mitrovicë/Mitrovica*
- *Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimit të Trafikut të Qenieve Njerëzore në Prishtinë/Priština*
- *Qendra për Mirëqenien e Grave – Shtëpia e Sigurtë në Pejë/Peć*

E regjistruar si një organizëm formal në 2011-ën por në mënyrë joformale ekzistuese që prej 2006, misioni i saj është ai i eliminimit të çdo forme të dhunës dhe diskriminimit ndaj grave dhe fëmijëve, promovimin e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në proceset demokratike të vendit.

Gjatë viteve KSK-ja ka realizuar projekte te shumta në mbështetje të grave dhe të fëmijëve, të financuara nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë. Këto projekte ju kanë dhënë secilës qendër kundër dhunës aftësi më të madhe për të ndikuar në realitetin e jashtëm dhe aftësi më të mëdha për të mbështetur gratë, ndërsa si Koalicion, kanë lejuar secilës qendër të shquhen si bashkëbisedues të privilegjuar prej institucioneve në hartimin e ligjeve madhore në mbrojtje dhe mbështetje të jetëve të dhunës dhe trafikimit.

Deri më sot, KSK-ja vazhdon të ndjekë objektivat e saj për parandalimin e dhunës, duke mbështetur gratë dhe fëmijët viktime dhe funksionin e avokimit në Qeveri.

Kontakte

Adresa : Ulpiana, Str. Imzot Nikë Prela, 45, 10000, Prishtinë/Priština
Tel./Fax: +381 (0) 38545476
E-mail: kosovosheltercoalition@gmail.com
Web: www.ksk-ksc.net

CCAER – KOORDINIMI I QENDRAVE KUNDER DHUNES TË EMILIA ROMAGNA



CCAER është një shoqatë e nivelit të dytë e themeluar në vitin 2009 në Bologna (Itali). Ajo përbëhet prej 13 Shoqatave të Grave me seli në territorin e Regjionit Emilia Romagna, që kanë si qëllim luftën kundër dhunës ndaj grave. Ato besojnë se dhuna ndaj grave është dhunë që i ka rrënjët në pabarazinë e pushtetit mes gjinive.

Karakteristika të përbashkëta për të gjithë 13 anëtarët e Shoqatave të Grave CCAER janë:

- (1) Menaxhimi i shërbimeve të pranimit për gratë e vetme ose me fëmijë/dhe që kanë përjetuar dhunën pa dallim nga raca, feja, kultura dhe profesioni.
- (2) Zbatimi i projekteve të trajnimit dhe fuqizimit femëror.
- (3) Një metodologji e pranimit të bazuar në marrëdhëniet në mes të grave: operatorët/ vullnetarët/anëtarët/konsulentet janë gra që punojnë sipas parimit të vlerësimit dhe përforcimit të gjinisë femërore.

CCAER lind nga një praktikë konkrete e marrëdhënieve dhe shkëmbimit ndërmjet qendrave kundër dhunës që është krijuar ndër vite falë zbatimit të projekteve të përbashkëta të hulumtimit-veprimit dhe trajnimit. Këto projekte të përbashkëta iu kanë ofruar çdo qendre kundër dhunës njohuri dhe aftësi më të mëdha për të ndikuar në realitetin e jashtëm.

CCAER kanë lindur pra, nga nevoja për të formalizuar këtë bashkëpunim ndërmjet secilës qendër kundër dhunës dhe i përgjigjet dëshirës për fuqizimin e aktiviteteve dhe dukshmërisë së tyre në territor.

Funksionet kryesore të CCAER janë:

- Identifikimi i objektivave politike dhe planifikimi vjetor i veprimeve që shoqatat synojnë për t'i realizuar.
- Të lehtësojë shkëmbimin e ideve, krahasimin, mbështetjen, vlerësimin reciprok midis Shoqatave.
- Promovimi i njohurive dhe shkëmbimi i përvojës lidhur me projektet e reja të zhvilluara nga organizatat individuale në mënyrë që të mbështesin të tjerat që duan të zbatojnë projekte të ngjashme.
- Zhvillimi i projekteve të përbashkëta kërkimore për të rritur ndërgjegjësimin e opinionit publik mbi problemin e dhunës dhe për të rritur njohjen e fenomenit .
- Të projektojë kurse trajnimi për profile të ndryshme profesionale ndër të tjera, me policinë, personelin socio-shëndetësor, mësuesit, etj.
- Të organizojë konferenca, debate, seminare për të thelluar tematikën e dhunës ndaj grave dhe nxitjen e ndërgjegjës kolektive , mediave dhe institucioneve.
- Të promovojë aktivitete edukative drejtuar operatoreve/vullnetareve me qëllim shkëmbimin e metodologjive për të thelluar dhe zhvilluar aftësi të reja;
- Të jetë forcë bashkëbiseduese për institucionet vendore mbi çështjen e dhunës ndaj grave dhe për të futur e përmirësuar ligjet në lidhje me të drejtat e grave.

Kontakte

Adresa: Via dell'Oro 3, Bologna (BO)

Tel./Fax: +39 051 333173

E-mail: centriantiviolenzaer@women.it

Web: www.centriantiviolenzaer.it

ABGJ – AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE



ABGJ vepron si agjenci e pavarur në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës dhe merret me lehtësimin, promovimin dhe monitorimin e zbatimit të Programit Kombëtar për Barazi Gjinore 2008-2013 dhe Planit Kombëtar kundër Dhunës në familje 2011-2014.

Stafi i ABGJ-së përbëhet nga 18 operatorë që punojnë në 4 divizione: Legjislacioni, Bashkëpunimi, Monitorimi, Administrata dhe Financa.

ABGJ-ja promovon adoptimin e parimit të barazisë gjinore brenda institucioneve publike:

- Duke kontribuar në hartimin e projektligjeve apo rishikimin e legjislacionit në fuqi, duke integruar çështjet e lidhura me barazinë gjinore .
- Duke iu siguruar ndihmë teknike administratës publike dhe organizatave të shoqërisë civile në përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e programeve për promovimin e mundësive të barabarta.
- Duke koordinuar zbatimin e projekteve për barazinë gjinore .
- Duke realizuar dhe përhapur hulumtime mbi çështjet gjinore.

Roli i ABGJ-së në projekt, është të:

- sigurojë të dhëna dhe informata mbi temën e dhunës në familje, të transmetojë përditësime në lidhje me zbatimin e Planit Kombëtar kundër Dhunës në Familje,

- të lehtësojë marrëdhëniet me institucionet lokale për zbatimin e planeve të riintegritimit social të gratë përfituese të ndërhyrjes dhe,
- të lehtësojë krijimin e bashkëveprimit me nisma të tjera të realizuara nga aktorë të tjerë rreth çështjes e dhunës në baza gjinore në Kosovë.

Kontakte

Adresa: Ndertesa e Qeverisë, Sheshi Nëna Terezë,
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel./Fax: +381 38 200 14 280
E-mail: abgj@ks-gov.net
Web: <http://abgj.rks-gov.net/>

PROJEKTI REVIVE -

*Reintegration of Victims of domestic
Violence - Riintegrimi i Viktimave të
Dhunës në familje*



revive

*Nga Francesco Gradari **

REVIVE është një projekt që ka lindur nga reflektimi mbi rolin e grave dhe rëndesën e fenomenit të dhunës në baza gjinore në Kosovë. Duke filluar pikërisht nga ky reflektim, RTM që prej 10 vite angazhimi në Kosovë pranë shoqatave të grave rurale, ka vendosur t'i afrohet realiteteve të shoqërisë civile kosovare që në radhë të parë janë marrë me mbrojtjen e të drejtave dhe mbështetjen e grave viktime të dhunës. RTM dhe KSK janë takuar në vitin 2011. Nga ky takim lindi ideja për të zhvilluar një propozim-projekt që do t'i pergjigjej nevojës së gruas për rikthim në shoqëri pas një rrugëtimit të vetëdijësimit të bërë së bashku me qendrat kundër dhunës pjesë e KSK-së.

Duke marrë parasysh vështirësitë e qenësishme në një intervenim të këtij lloji dhe Duke dashur të vlerësojë përsosmëritë e territorit të vet të origjinës (të Regjionit Emilia Romagna), RTM ka përfshirë në projekt CCAER-IN.

Vlera e shtuar e REVIVE qëndron pikërisht në përfshirjen dhe në shkëmbimin e nisur mes dy realiteteve të ngjashme për nga natyra dhe funksionet si KSK-ja dhe CCAER-i. Ata në sajë të përballjes së drejtpërdrejtë dhe të përditshme me gratë mysafire të secilës strehimore, kanë fituar me kalimin e kohës njohuri dhe praktika të specializuara në gjendje për të ofruar përgjigje të duhura nevojave të grave viktime të dhunës.

REVIVE mbështet krijimin e një rrjeti mes realitetit të shoqatave italiane dhe atij kosovar të angazhuar në luftën kundër dhunës ndaj grave, në qëllim që prej shkëmbimit të ndërsjellë të metodave të

punës të mund të përftohen mënyra të reja për të përballuar këtë fenomen, dimensionet e të cilit janë dramatike si nga njëra ashtu edhe nga tjetra anë e Adriatikut.

Me këtë projekt RTM, KSK dhe CCAER synojnë të nxisin riintegrimin social të grave viktime të dhunës në familje nëpërmjet përforsimit të aftësi profesionale të qendrave kundër dhunës dhe të shërbimeve publike të angazhuar në luftën kundër dhunës në baza gjinore në Kosovë. Më saktësisht, REVIVE synon të mbështesë qendrat kundër dhunës në veprimin e fuqizimit të grave të pranuar nga ana e tyre dhe në zhvillimin e bashkëpunimit me autoritetet lokale dhe shërbimet publike të pranishme në territoret përkatëse. Në këtë mënyrë REVIVE përfshihet në ndërveprim dhe kontribuon në zbatimin e Planit Kombëtar kundër dhunës në familje 2011-2014. Prej këtu lindë përfshirja në projektin e ABGJ që është subjekti përgjegjës për lehtësimin dhe monitorimin e tij.

Ky publikim është një aktivitet i projektit REVIVE, por është mbi të gjitha rezultat i një procesi të shkëmbimit ndërmjet strehimoreve të Kosovës dhe në mes tyre dhe strehimoreve të Emilia Romagna-s sa i përket riintegrimin të viktimeve të dhunës. Është një reflektim mbi praktikën e përditshme të aplikuar nga çdo qendër në mbrojtje të grave. Ndarja e bashkëpunimit që ndodhi midis qendrave kundër dhunës për t'i dhënë jetë këtij doracak është një dhuratë e dyfishtë: për vetë qendrat, sepse të gjithë mund të përfitojnë nga ajo që është e mirë tek tjetra; për ata që do t'a lexojnë sepse do të ndihmojë për të kuptuar kompleksitetin dhe ndjeshmërinë e punës së bërë nga një strehimore në Itali ashtu si edhe në Kosovë.

Për RTM, KSK dhe CCAER projekti REVIVE nuk është një ndërhyrje e rastësishme. Ajo përkundrazi, paraqet fillimin e një rrugëtimi dhe një angazhimi të përbashkët afatgjatë për të ofruar përgjigje konkrete ndaj nevojave të vërteta të grave viktime të dhunës në Kosovë.

** Projekt Menaxher për Rajonin e Ballkanit - RTM*

Skeda përmbledhëse Projekti REVIVE	
Vendi i realizimit:	Komunat e Pejës, Gjakovës, Prishtinës, Prizrenit, Gjiilanit, Mitrovicës
Subjekti udhëheqës:	RTM – Volontari nel Mondo
Partnerët:	KSK – Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës CCAER - Koordinimi i Qendrave Kundër Dhunës të Emilia Romagna
Institucioni asocijues:	ABGJ – Agjencia për Barazi Gjinore
Kohëzgjatja:	24 muaj (Korrik 2012 – Korrik 2014)
Grupet e përzgjedhura:	- 7 Qendra kundër dhunës [200 persona] - Punonjës socialë dhe psikologë [80 persona] - Mjekë profesionistë [90 persona] - Gjashtë Komuna të Kosovës [50 persona]
Përfituesit përfundimtarë:	Gra viktimat të dhunës në familje mysafire në qendrat kundër dhunës të Kosovës [400 persona/vit]
Rezultatet e pritshme:	(1) Përmirësim i shërbimeve të rehabilitimit të ofruara nga qendrat kundër dhunës në bashkëpunim me agjencitë socio-shëndetësore, me qëllimin e rritjes së vetëbesimit dhe aftësive të vetëvendosjes së viktimave. (2) Një strategji gjithëpërfshirëse për dhunën në familje është përvetësuar në 6 komunat e përzgjedhura.
Aktivitetet kryesore:	<i>PAKETA NR.1 – ZHVILLIMI I KAPACITETEVE</i> Trajnimi mbi fuqizimin e grave viktimat të dhunës në familje drejtuar operatoreve dhe operatorëve të qendrave kundër dhunës dhe të shërbimeve socio-shëndetësore. Publikimi i një doracakut përmbajtës i udhëzimeve mbi fuqizimin e grave viktimat të dhunës. Hartimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit midis qendrave kundër dhunës dhe shërbimeve socio-shëndetësore publike të pranishme në territor. Nisja e shërbimeve të reja pilote në qendrat kundër dhunës për mbështetje të viktimave të dhunës. <i>PAKETA Nr.2 – VEPRIMET E RRJETIT DHE BASHKËPUNIMI</i> Krijimi i tabelave të koordinimit në nivel komunal për dhunën në familje. Miratimi i planeve të veprimit lokal kundër dhunës në familje. Nisja e iniciativave pilote për promovimin e riintegritimit në punë dhe banim të grave viktimat të dhunës.
Donatorët:	Bashkimi Evropian (EIDHR - CBSS Kosovë 2011) Regjioni Emilia Romagna (Itali) Provinca e Modenës – Fondi Territorial për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Itali)

PARATHËNIE

Dialogu dhe shkëmbimi ndërmjet qendrave kundër dhunës të Kosovës dhe të Regjionit Emilia Romagna.

*nga Naime Sherifi **

Në këto dy vjet të projektit aktivitetet e kryera bashkarisht nga KSK dhe CCAER falë edhe veprimt të cmuar të lehtësimit dhe të vazhdueshëm të realizuar nga RTM, kanë qenë të shumta. Shkëmbimi i përvojave mes CCAER dhe KSK ka qenë sigurisht i frytshëm me synim të përforcimit të punës së KSK-së dhe të qendrave kundër dhunës që e përbëjnë në procesin e rehabilitimit dhe riintegrit social të viktimave, duke përfshirë punën e rrjetit me akterët lokalë të pjesë e procesit e riintegrit të grave dhe të bisedimeve në nivel institucional, me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore më afër nevojave të viktimave.

Shkëmbimi i praktikave të mira me CCAER në fushën e rehabilitimit të grave viktime të dhunës ka përbërë një pikë kyçe reflektimi për KSK-në: të dyja koalicionet arritën t'i ndajnë njohuritë mbi përforcimin e punës në rrjet, mbi metodat e punës me viktimat dhe mbi mekanizmat e funksionimit të brendshëm ndaj koalicioneve përkatëse.

Vizitat në qendrat kundër dhunës, trajnimet dhe seminarët e realizuara në kuadër të projektit REVIVE nga operatorët e CCAER, RTM dhe KSK, kanë qenë mundësi shkëmbimi të rëndësishme në të cilat të ndaheshin përvoja e praktika të mira. Këto momente kanë sjellë në një përforcim të KSK-së si shoqatë ombrellë dhe kanë bërë risi e njohuri të reja në çdo qendër kundër dhunës që e përbën, për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për gratë viktime të dhunës në familje, si gjatë periudhës së strehimit në strehimore ashtu në procesin e riintegrit të tyre në shoqëri.

Dhuna kundër grave në Kosovë është një fenomen që bëhet gjithnjë më i dukshëm, siç janë të dukshme lidhjet me faktorë të shumtë si çështjet ekonomike, kulturore, sociale, traditat familjare dhe problematikat tjera.

Duke konsideruar sa e vështirë është gjendja e përjetuar prej grave që pësojnë dhunë familjare, mund të them se sa e vështirë dhe komplekse është puna e qendrave kundër dhunës dhe e subjekteve të tjera të rrjetit që ofrojnë shërbime komplekse dhe të ndjeshme ndaj viktimave të dhunës.

Prandaj, puna dhe përkushtimi i akterëve të përfshirë në luftën ndaj dhunës familjare mbetet një çështje jetësore për vendin tonë, me qëllimin për të ofruar përgjigje të vlefshme për të gjitha ato viktimat të dhunës familjare që dëshirojnë t'i japin fund dhunës dhe të ndërtojnë një jetë të pavarur, duke i gëzuar plotësisht të drejtat vetjake.

** Udhëheqëse e KSK dhe Drejtoreshë e Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijeve në Prishtinë.*

*nga Alessandra Campani dhe Elisa Bianchi ***

Që prej fillimeve të viteve nëntëdhjetë, qendrat kundër dhunës italiane kanë ndjerë nevojën të takohen çdo vit për një shkëmbim intensiv dhe joformal kundrejt metodës së pranimit dhe strehimit të grave në brendësi të strehimoreve, ndaj formimit dhe organizimit të kuvendeve dhe seminareve mbi temën e dhunës ndaj grave. Me siguri mund të thuhet që në rajonin Emilia Romagna qendrat kundër dhunës kanë qenë menjëherë më aktive dhe të numërta përballë realiteteve të tjera.

CCAER bashkon trembëdhjetë qendra kundër dhunës aktive në Emilia Romagna: trembëdhjetë realitete të rrënjësura në rajon që

1. www.nondasola.it

merren me punën thelbësore të pranimit dhe strehimit të grave viktime të dhunës dhe që ndajnë metoda të ndërhyrjes, praktika të mira dhe projekte. CCAER përveq tjerash, zhvillon një punë të pandërprerë të informimit dhe sensibilizimit mbi dhunën gjinore. Qendrat kundër dhunës e përballojnë problemin duke zhvilluar një punë të çmueshme të parandalimit: kurse edukimi gjinor në shkollat e larta, punëtori trajnimi, takime me mësues, iniciativa dhe fushata drejtuar adoleshenteve/ëve. Mjetet ligjore, subvencionet publike dhe mbështetja institucionale janë të nevojshme për t'i dhënë zgjidhje konkrete problemit dhe për të ndihmuar konkretisht gratë viktime të dhunës. Qëllimet e CCAER kanë qenë gjithmonë të dyfishta: njëra e brendshme e destinuar për shkëmbimin mbi metodat e pranimit, për ballafaqim mbi projekte specifike, mbi kontraktimet me autoritetet lokale, rritje dhe mbështetje të ndërsjellë; tjetra e lidhur me kohezionin dhe forcën për të propozuar politika të nivelit rajonal.

Në këto vite CCAER u bë bashkëbisedues i drejtëpërdrejtë me administratën regjionale, duke gjetur mbështetje për nisma, projekte, financime për aktivitete hulumtuese, si dhe për realitetet lokale. Në nivelin politik regjional CCAER prej vitesh shfaq rëndësinë e aktivimit të tryezave të rumbullakëta ndër-institucionale mbi dhunën ndaj grave, në të cilat mund të marrin pjesë të gjithë ato subjekte që merren me aktivitetet e parandalimit dhe ndërhyrjes mbi këtë tematikë. Tryezat janë një nismë thelbësore e programimit midis Regjionit, autoriteteve lokale, forcave të rendit, shërbimeve sociale dhe shëndetësore, institucioneve të arsimit dhe shoqatave të shoqërisë civile.

CCAER i ka besuar para së gjithave Shoqatës Nondasola¹ të Reggio Emilia zbatimin e aktiviteteve të këshillimit dhe trajnimit të parashikuara në brendësi të projektit REVIVE.

Gratë e shumta viktime të dhunës të pranura çdo ditë shtyjnë strehimoret e përhapura nëpër botë të eksperimentojnë ndarjet e përvojave në distancë, përfitimet e mundshme të praktikave të mira

për të promovuar politika të përkujdesjes ndaj grave dhe lirive nga format e ndryshme të dhunës. Kjo sepse, edhe pse kornizat legislative të një vendi janë të mira, është zbatimi real i ligjeve që dallon në kuptimin e respektimit të të drejtave të grave. Ky projekt ka qenë para së gjithash një mundësi e çmuar e shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të strehimoreve të Kosovës dhe të Regjionit të Emilia Romagna-s, që veprojnë për mbrojtjen dhe njohjen e të drejtave të grave dhe mes vetë grave që ndihmohen për afirmimin e një lirie femërore të njehsuar. Qëllimi ka qenë vendosja e kushteve për një ballafaqim të barabartë, ku secila strehimore do të mund të tregojë sipas aftësive të veta, pikat e forta dhe praktikat e mira, por njëkohësisht të gjente një hapësirë për të ndarë së bashku përpjekjet, pikat kritike, kufinj të për mirësim.

Ballafaqimi u zhvillua në tri nivele:

- (1) puna me gratë e keqtrajtuara me vëmendje të vecantë tek proceset e riintegrit;
- (2) aktivitetet e parandalimit dhe të ndërtimit të rrjeteve lokale në mbështetje të grave viktime të dhunës;
- (3) trajnimi i subjekteve të rrjeteve.

Ky ballafaqim ka nxjerrë në pah dallime të rëndësishme mes dy koalicioneve: historia e ndryshme e lindjes së strehimoreve në Emilia Romagna (të lindura më herët dhe të rrënjosura në lëvizjet politike të grave) dhe në Kosovë (më të vonshme, mbi dallgen e emergjencës së luftës); konteksti i ndryshëm historik, kulturor dhe social në të cilat strehimoret veprojnë (qendrat e Emilia Romagna-s veprojnë në territore më të ndërgjëgjësuar, me autoritete lokale dhe institucione më të përgjegjësuar, me burime ekonomike më të mëdha); mënyrat e ndryshme të mbështetjes ndaj viktimeve të dhunës (në Kosovë të gjitha qendrat menaxhojnë vetëm strehimore, ndërsa në qendrat e Emilia Romagna-s ofrojnë procese të mikëpritjes, një linjë telefonike të posaçme dhe strehim); aktiviteti më i gjatë i CCAER që mundëson përfitimin e një bagazhi me shumë rezultate, praktika të mira të konsoliduara, përvoja të tejkaluara. Nga njëra anë, këto ndryshime kanë krijuar pasuri, kureshtje,

dëshirë të ndërsjellë për të ditur dhe njohur. Nga ana tjetër kanë rritur kompleksitetin e ballafaqimit, duke zgjatur kohët e ndërtimit të besimit të ndërsjellë dhe duke na nxitur të përcaktojmë së bashku objektiva, pritshmëri dhe rezultate që do të vijnë.

Kështu që e rimenduam planin e shkëmbimit në mënyrë që dallimet të mos ishin hapësira të paplotësueshme, por të ishin shqyrtuar dhe bërë pjesë integrale e përvojave të ndërsjella.

Lidhja që i ka mbajtur bashkë këto dallime dhe në të cilat të dyja koalicionet, CCAER dhe KSK e njohin veten, është dëshira për të mbajtur lart vëmendjen mbi dukurinë e dhunës, të promovojnë marrjen e përgjegjësive mbi këtë problem nga ana e institucioneve, të investojnë në parandalim, të vijojnë të jenë përkrah grave të keqtrajtuara, pavarësisht vështirësive, burimeve të pakta, paragjykimeve, rezistencës kulturore për të njohur dhunën si dhunim i të drejtave të njeriut, që shpesh ngadalëson zbatimin e duhur të ligjeve në mbështetje të viktimave.

Duke marrë shkas nga këto konsiderime dhe duke patur parasysh historinë e tanishme të strehimoreve në Kosovë dhe të KSK-së, ftesa jonë ishte që t’u jepej vlerë më e madhe përvojës së tyre, qoftë kolektivisht qoftë si qendër e vetme: rielaborimi i përvojave me gratë e keqtrajtuara do të thotë “të sistematizosh” njohuri dhe aftësi personale të “këtyre vendeve”, të mund t’i transmetosh jashtë si subjekte të kualifikuara dhe të njehsuara për t’a bërë këtë, të bëhesh një pikë e rrjetit besueshmëria e të cilit rrjedh nga “veçantia” e një njohurie të provuar në praktikë.

Nga përvoja jonë, është pikërisht kjo njohuri që na mbështet të promovojmë jashtë një ndryshim të marrdhënieve midis burrave dhe grave në respekt dhe njohje të ndërsjellë.

*** Këshilltare dhe trajnuese të CCAER.*

HYRJE

*nga Danila Zizi **

Figura femërore lidhet shpesh me idenë e bashkimit dhe ngrohtësisë familjare. Koncepti i gruas që realizon feminitetin e saj në mëmësinë dhe në familje është bërë me kohë pjesë integrale e shumë kulturave. Shoqëria kosovare bazon deri më sot identitetin e vet në këtë parim dhe e “lidh” gruan me një rol pasiv të bashkëshortes dhe nënës. Ky rol ka krijuar me kohën një pabarazi gjinore që ka gjetur pasqyrimin e saj si në dhunën brenda jetës familjare, ashtu edhe në heshtjen brenda së cilës u kufizua gjenocidi femëror i pësuar prej grave gjatë konfliktit².

Gjatë pasluftës, ndërgjegjësimi i pavarësisë së re të fituar, vuajta e përjetuar në të kaluarën dhe ndikimi ndërkombëtar çuan në një rizgjim të ngadaltë të ndërgjegjes dhe në reflektimet e para mbi rolin e gruas në shoqërinë shqiptare të Kosovës. Gjatë viteve, janë zhvilluar studime dhe hulumtime të ndryshme mbi figurën dhe rolin e gruas. Rezultati ishte dalja e të dhënave alarmuese mbi shkallën e dhunës gjinore të ushtruar në vend. Vetëm në dyvjeçarën 2011-2012 Policia e Kosovës ka regjistruar 2067 raste të dhunës në familje. Në 79% të rasteve të regjistruara viktimat ishin gra. Në 2013 kanë qenë 743 gratë që kanë raportuar raste të dhunës³, për një total prej 278 më pak se në vitin 2012. Në këtë rënie të konsiderueshme në të dhënat zyrtare kundërvihet një rritje në aktivitetet e strehimoreve të grave në Kosovë: janë 500, në fakt gratë viktimat të dhunës të strehuara në vitin 2013, 90 më shumë se në vitin 2012⁴.

Autorët e dhunës janë kryesisht burra me të cilët gruaja ka një marrëdhënie dashurie: në 88% të rasteve në fakt, bëhet fjalë për partnerët dhe/ose ish-partnerët dhe në një masë më të vogël (10%) të anëtarëve të tjerë të familjes⁵.

Të dhënave zyrtare iu është shtuar më pas vlerësimi i ekonomisë dhunës së raportuar nga viktimat. Në këtë pikë të dhënat janë

2 Farnsworth Nicole. 2008. Exploratory Research on The Extent of Gender-Based Violence in Kosovo and its Impact on Women's Reproductive Health. Kosovo Women's Network: Prishtinë/Pristina p. 19.

3 KP Report 2013.

4 KSC Report 2013 prezentato al Ministero del Lavoro e del Welfare.

5 Agency for Gender Equality. 2008. Security begins at home, Prishtinë/Pristina.

kontradiktore dhe jo të përditësuar. Megjithatë, sipas studimit të kryer në vitin 2008 nga ABGJ, vetëm 10% e rasteve janë raportuar në polici, krahasuar me 25% të mesatares evropiane. Arsyet janë për shkak të faktit se dhuna është parë përgjithësisht si çështje private dhe familjare, të cilës i shtohet ngarkesa e madhe e turpit e perceptuar nga viktimat, nga droja e një përkeqësimi të dhunës, dënimi social dhe varësia ekonomike nga abuzuesi. Pjesa më e madhe e popullsisë beson se dhuna është një dukuri e zakonshme dhe me rrënjët në marrëdhënie, duke gjetur për këtë arsye si të pranueshme që të shfaqet edhe në lidhjet familjare.

Kompleksiteti i strukturës sociale, dhe referimi kulturor patriarkal i popullsisë kosovare, bën veçanërisht të vështirë raportimin nga ana e gruas e gjithashtu edhe vetë punën e personave të angazhuar kundër dhunës gjinore.

Strehimoret që janë cekur në këtë botim nxjerrin dukshëm fuqishëm pabarazinë e pushteteve midis burrave dhe grave dhe rëndësinë e punës në mbështetje të viktimave të dhunës me një qasje të fokusuar tek gratë dhe nevojat e tyre.

Të mbështetësh gruan në të menduarit për nevojat e veta, t'a shoqërosh në rrugën e pavarësisë janë disa nga elementet që i karakterizojnë strehimoret. Strehimoret kanë zhvilluar me kohën përvojë të konsiderueshme në shërbim të parandalimit të dhunës dhe mbrojtjen e viktimave, por kanë vazhduar të hasin pengesa në procesin e rehabilitimit dhe riintegritit social të grave për shkak të kompleksitetit të nevojave të tyre, si dhe për shkak të mungesës së bashkëpunimit me akterë të tjerë të rrjetit.

Të vetëdijshëm për rrezikun e një kthimi të dhunës të cilat përjetuar nga gratë që fillojnë një rrugëdalje nga kjo e fundit, strehimoret synojnë që përmes këtij doracaku dhe në përgjithësi me projektin REVIVE, të njihet më shumë dhe të nxisë një dialog me shërbimet publike të pranishme në territoret përkatëse në të cilat ato veprojnë. Për këtë arsye, në doracak sillen përvojat konkrete të riintegritit të grave viktimave të dhunës të realizuara nga qendrat, me problemet e tyre dhe sukseset e vogla por të mëdha.

** Koordinator e projektit REVIVE - RTM*

PJESA E PARË

Të dalësh nga dhuna

1.1 Dinamikat dhe pengesat me të cilat ballafaqohen gratë në dalje nga marrëdhëniet abuzive.

Tregimi i përjetimit femëror brenda dhunës duhet domosdoshmërisht të marrë parasysh kontekstin socio-kulturor të vetë gruas. Megjithatë, është e mundur të identifikohen disa karakteristika të përbashkëta dhe dalluese të vështirësive të gruas në situata të dhunës.

Një tipar i parë i përgjithshëm, nga ku mund të fillohet është ajo e konfliktit të fortë të brendshëm që shkakton tek gruaja forcën e marrëdhënies afektive dhe emocionale drejt burrit keqtrajtues. Të dallojë që pëson dhunë, të pranojë dështimin e marrëdhënies dhe vlerën e atribuar rolit femëror në familje e bën edhe më të mundimshme zgjedhjen e gruas. Nga njëra anë, kjo ndjen përgjegjësinë për të siguruar mirëqenien dhe unitetin e çiftit, nga ana tjetër, percepton nevojën për të mbrojtur veten dhe, nëse janë të pranishëm, fëmijët e tyre.

Në shoqërinë kosovare ky element është mjaft i pranishëm. Në fakt në të, me martesën shënohet kalimi i gruas nga përkatësia e familjes së babait me atë të burrit të saj. Pritshmëritë që krijohen rreth gruas shndërrohen në mekanizma të kontrollit joformal mbi vetë gruan. Këto pritshmëri i shtojnë gratë nga njëra anë, që t'i përmbahen idealit kulturalisht të pranuar i të qenurit vetëm nënë, bashkëshorte, nuse; nga ana tjetër, që t'i druhen qortimit dhe izolimit në rastin e rrebelimit. Ky presion social shtyn gruan që të mbetet në familjen e burrit të saj, për të rritur pragun e tolerancës së dhunës ushtruar ndaj tyre dhe për të ndryshuar në të njëjtën kohë sjelljet e tyre për të përmbajtur agresivitetin e partnerit.

Pragu i tolerancës ndaj dhunës së perceptuar nga gruaja bëhet veçanërisht i lartë aty ku shpërthimeve të dhunës përzihen edhe sjelljet emocionale dhe të dashurisë nga ana e burrit.

Në fakt, dinamikat që lindin në marrëdhëniet e dominuara nga pabarazitë gjinore ndjekin në përgjithësi një skemë të ngjashme dhe ciklike. Pas një episodi akut të keqtrajtimit, burri zakonisht ndërmeret sjellje që kanë për qëllim të pranojnë faljen dhe për t'ia atribuar përgjegjësitë e veprimeve të tyre faktorëve të jashtëm (p.sh., të punës, pretendimet se gruaja e ka provokuar).

Si reagim, gruaja zhvillon strategjitë e vetë-kufizimit për të përmbajtur, edhe pse pa sukses, dhunën nga partneri. Rritet brenda viktimës një ndjenjë pafuqishmërie në përballje të sulmeve të burrit, i cili do të ketë tendencën për të riprodhuar gjithnjë e më shpesh mënyra të kota me të cilat të anullojë vullnetin e gruas duke e bërë të varur prej tij.

Me kalimin e kohës, koha që kalon ndërmjet një akti të dhunës dhe atij pasardhës reduktohet në mënyrë të konsiderueshme deri sa tensionet dhe agresionet nuk dominojnë plotësisht marrëdhënien e çiftit. Pasojat e dhunës janë të reflektuara edhe në nivelin ekonomik. Edhe pse në Kosovë gruaja tashmë vuan nga një disavantazh i rëndësishëm në drejtim të mundësive të punësimit në raport me meshkujt, dhuna nuk bën asgjë por vetëm e zgjeron një situatë të tillë. Izolimi në rritje dhe pasojat e dhunës fizike dhe psikologjike shpesh i çojnë gratë në humbjen e vendeve të punës dhe/ose tek pengesa në kërkimin e saj.

Shkalla e papunësisë femërore arrinë 40% të popullsisë aktive: ajo është shumë më e lartë se ajo e meshkujve (28%). Gratë gjithashtu kanë më pak mundësi qasjeje në mundësitë për zhvillim profesional dhe për të filluar biznesin e tyre: vetëm 9% e vetëpunësimit është aktualisht në duart e grave⁶.

6 World Bank. 2012. Kosovo: Gender Gaps in Education, Health and Economic Opportunities .World Bank: S.n.,p. 21.

Pasojat e dhunës në nivel ekonomik janë përkeqësuar nga mungesa e "sundimit të ligjit". Aty ku i pranishëm, legjislacioni për mbrojtjen e barazisë gjinore është injoruar sistematikisht. Simbolik është mohimi i të drejtës së trashëgimisë së grave. Zakone të vazhdueshme u mohojnë grave posedimin e pasurisë familjare të trashëguar. Është zakon ende i fortë dhe i rrënjosur të lënë vajzën, që është bërë bashkëshorte, të hyjë në familjen e burrit pa pasuri. Deri më sot, vetëm 10% e grave i qasen pronës së familjes, krahasuar me 80% të meshkujve⁷. Pushteti, autoriteti dhe prona dmth. kalojnë përgjatë vijës mashkullore të trashëgimisë.

Normat sociale të pashkruara rregullojnë marrëdhëniet duke iu caktuar të dyja gjinive role, përgjegjësi dhe pritshmëri të ndërsjella që janë formësuar "duke u natyralizuar". Burri është kreu i familjes, ai i cili mendon për nevojat e familjes dhe merr vendime në jetën publike, ndërsa gruaja priret të mbetet e mbyllur në ambientin shtëpiak dhe të përkujdeset për familjen.

Në këtë kontekst, gruaja nuk gjen rreth vetes një ambient të gatshëm për ta pranuar dhe për t'a mbështetur, por një mjedis që pengon çdo projekt të pavarësismit. Ajo është pra, e detyruar të tërhiqet dhe të kufizojë vetveten në rolin e nënës dhe gruas. Në rastet kur gruaja është viktimë e dhunës, ndjenja e izolimit është më e madhe. Roli i gruas dhe nënës bëhet jo vetëm një realitet kundër të cilit është e vështirë për të luftuar, por një burg nga i cili është e vështirë të tërhiqesh.

Një komunitet i vetëdijshëm dhe në gjendje të njohë dhunën dhe kompleksitetin e saj mbështet viktimën e dhunës duke iu dhënë përgjigje të përshtatshme nevojave të veçanta të gruas dhe duke e ndihmuar të ndjehet më pak e vetmuar dhe e pafuqishme. Në këtë kuptim, një përgjigje e integruar dhe bashkëpunuese me të gjitha shërbimet e pranishme në terren i ndihmon viktimat të rigjejnë vetëbesimin, për të ndërmarrë një rrugë të autonomisë dhe liritimit nga dhuna më pak të vështirë dhe traumatike.

⁷ Kosovar Center for Gender Studies. 2011. Women's property inheritance rights in Kosovo. p. 41.

1.2 Nga dhuna drejt fuqizimit.

1.2.1 Strehimoret në Kosovë: origjina, misioni dhe zhvillimet

Themelimi e strehimoreve të grave në Kosovë i referohet historikisht pas-luftës dhe nevojës për të dhënë mbështetje për gratë që dolën nga një konflikt i dhimbshëm. Lufta, por sidomos pas-lufta në Kosovë kanë marginalizuar dhimbjen e gruas si grua⁸. Strehimoret lindin në këtë kontekst për "të feminizuar"⁹ luftën, duke ofruar dëgjim dhe mbështetje për gratë viktime të abuzimeve gjatë konfliktit.

Falë edhe mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë, me kalimin e kohës këto strehimore filluan të transformohen, për të vlerësuar nevojat e ndryshme të grave, të sigurojnë strehim të përkohshëm dhe shërbime mbështetëse në rastet e dhunës jo vetëm nga konflikti, si përdhunimi, por edhe të atyre gjinore. Zëri i strehimoreve fillon të marrë një forcë të re në rikërkimin e kushteve më të mira të jetesës për gratë dhe respektimin e të drejtave të tyre.

Në këtë moment të veçantë historik, ndërmjet fundit të viteve '90 dhe fillimit të viteve 2000, lindën zyrtarisht 7 strehimore të menaxhuara nga po aq shoqata të grave në komunat kryesore të Kosovës.

Si vijim, strehimoret dhe shoqatat relative u bënë 8. Nga këto njëra është e specializuar në pranimin e grave viktime të mundshme të trafikimit, një tjetër në mbrojtjen e të miturve. 6 qendrat e mbetura përqendrohen në mbrojtjen dhe mbështetjen e grave viktime të dhunës në familje.

Megjithëse secila nga këto strehimore ka veçantitë e veta, ato

8 Vlerësohet të kenë qenë të paktën 20.000 gratë viktime të përdhunimit gjatë konfliktit, kurse i papërcaktuar numri i fëmijëve të lindur prej këtyre dhe të braktisur nëpër spitale të ndryshme ose thjesht në rrugë. Në mes këtyre 20.000, pak, në mos asnjëra është dëgjuar, ose ka, treguar jashtë dramën e vet. Rape victims' babies pay the price of war, nga Helena Smith, The Observer, Sunday 16 April 2000
<http://www.theguardian.com/world/2000/apr/16/balkans>.

9 DEP, Lo stupro della nazione: le donne raccontano il genocidio, nga Rodin Lentin.
<http://www.unive.it/media/allegato/dep/n10-2009/Ricerche/Lentin.pdf>.

bazohen në kushte të caktuara dhe parime të përbashkëta. Bëhet fjalë për strehimore të drejtuara nga gratë që kanë kombinuar profesionalizmin e tyre me një lexim të dhunës gjinore. Në kundërshtim me idenë e dhunës në marrëdhëniet intime, si fenomen privat dhe individual për shkak të fshehtësisë së mureve shtëpiake, ato veprojnë që dhuna të shihet si një çështje sociale dhe kulturore dhe për këtë në interes të publikut.

Është gjithmonë me synimin për rrugën e zhvillimit dhe të ndërgjegjësimit që lind ndërmjet strehimoreve, ideja e formimit të një koalicioni të nivelit të dytë. Kjo ide e lindur jozyrtarisht që nga viti 2007, në kuadër të saj strehimoret individuale bashkojnë burimet e veta në mënyrë që të fitojnë më shumë pushtet, autoritet dhe aftësi negociuese me Institucionet.

Katër vjet më vonë (2011) sheh dritën KSK - Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës, OJQ ombrellë e regjistruar sipas rregullave në Kosovë. Ndër objektivat e KSK-së janë: konsolidimi dhe standardizimi i shërbimeve të ofruara nga strehimoret; parandalimi i dhunës përmes aktiviteteve të vetëdijësimit; përforcimi i rolit të strehimoreve përmes lobimit të kombinuar; avokimi dhe mbledhja e fondeve; promovimi i ligjeve, politikave dhe strategjive që kanë të bëjnë me mbrojtjen e grave dhe fëmijëve viktime të dhunës¹⁰ .. Pas krijimit të vet formal, KSK-ja sheh të rritet autoriteti i vet dhe gradualisht bëhet një bashkëbisedues kombëtar mbi dhunën. Në vitin 2012, KSK-ja nënshkruan një memorandum për mbështetjen e drejtpërdrejtë të grave të strehuara në qendra me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). KSK-ja dhe/ose strehimoret e veçanta që janë pjesë e saj nisin më pas bashkëpunime me institucionet e tjera qeveritare, në mesin e të cilave, me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit, ABGJ dhe me komunat përkatëse.

Në vazhden e punës së strehimoreve dhe të kërkesave urgjente të shoqatave që merren me mbrojtjen e të drejtave të grave, Qeveria e Kosovës filloi të miratojë legjislacionin dhe politikat për të luftuar dhunën kundër grave. Në vitin 2010 hyn në fuqi një Ligj specifik

11 Kosovo Shelter Coalition, Program, Strategy and Action Plan, and Standards for Shelters functioning of Kosovo Shelter Coalition, themeluar nga USAID dhe IOM 2011.

mbi mbrojtjen kundër Dhunës në Familje, dhe vitin që pasoi miratoi Strategjinë Kombëtare kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit përkatës. Ajo përmban masa konkrete për të luftuar dhunën në familje, nga parandalimi tek shërbimet e rehabilitimit dhe riintegrimin.

Të tjerë hapa përpara, që konfirmojnë njohjen për punën e bërë nga strehimoret, janë promovimi në vitin 2013 i një sërë masash konkrete për zbatimin e ligjit kornizë mbi dhunën në familje, dhe miratimi i "Procedurave Standarde të Operimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë" (PSO). Në sajë të këtyre të fundit përcaktohen rolet dhe masat e veprimit në fushën e dhunës në familje, organet përgjegjëse të krijuara për trajtimin e saj me qëllim për të forcuar bashkërendimin ndërmjet autoriteteve të ndryshme lokale në një sistem të integruar përgjigjesh ndaj dhunës në familje.

1.2.2 Funksioni i strehimoreve.

Si përkufizim, strehimorja lindi për të luftuar dhunën dhe për të bërë një ndryshim në nivel kulturor me qëllim që marrëdhënia midis burrave dhe grave të bazohet në njohjen e të drejtave dhe mundësive të barabarta. Një funksion thelbësor i strehimoreve është pikërisht që të tërheqin vëmendjen e shoqërisë në lidhje me shtrembërimet që ekzistojnë në të, në fushën e barazisë gjinore. Vetë prania e strehimoreve në territor e bën të dukshëm fenomenin e dhunës ndaj grave, duke nxitur marrjen e përgjegjësisë nga ana e komunitetit. Strehimoret gjithashtu veprojnë për të siguruar mbrojtje, mikëpritje dhe mbështetje për viktimat e keqtrajtimin si në fazën emergjente, si përgjatë rrugës e cila synon daljen e gruas nga dhuna. Një strehimore është fatkeqësisht një observator i privilegjuar në fushën e dhunës në marrëdhëniet intime: pikërisht për këtë arsye, ajo është një aktere kyç dhe thelbësore në përcaktimin e parimeve të konsoliduara të ndërhyrjes dhe të metodave efikase për mbështetjen e grave viktimat të dhunës.

Edhe pse të lindura dhe të rrënjosura në territore të ndryshme, strehimoret e Kosovës i bashkon ideja për të luftuar sistemin e nënshtrimit në të cilin gratë historikisht janë caktuar dhe nga i cili

ato luftojnë për të dalë.

Gratë e strehimoreve mbështesin gra të tjera të cilat vendosin të ndërmarin një rrugëtim të çlirimit të dhunës dhe e ruajnë në kujtesë atë. Kujtimi i dhunës është një pikë e rëndësishme e punës së strehimoreve. Shpesh gratë që kërkojnë ndihmë bartin me vete pasojat e përvojave traumatike për vite me rradhë.

Këto përvoja të dhimbjes dobësojnë fuqishëm vetëbesimin e gruas, duke e bërë atë të zhytet në një ndjenjë të pafuqisë, izolimit dhe dëshpërimit.

Gratë viktimat të dhunës kryejnë përpjekje të ndryshme për t'i dhënë fund keqtrajtimit. Së pari nga brenda duke u përpjekur t'a kufizojnë dhe kontrollojnë dhunën e burrit. Dhe

pastaj duke kërkuar mbështetje jashtë, pranë familjarëve, miqve, grave të tjera dhe/ose duke iu drejtuar institucioneve lokale siq janë spitalet, klinikat, shërbimet sociale dhe policia. Këto gra shpesh e mohojnë, fshijnë kujtimin e dhunës së përjetuar shumë dhe shpesh herë para se t'a gjejnë veten në kujtime për t'i përballuar ato.

Qëllimi i punës së strehimoreve grave pra është, edhe ai për të shoqëruar viktimat në rrugën e fuqizimit. Kjo ndodh përmes rizbulimit dhe vlerësimit të vetvetes dhe burimeve të saj të brendshme, forcimit të aftësive të tyre vendimmarrëse, ruajtjen e kujtesës së dhunës së përjetuar nga këto gra që ajo të kalojë pas gjeneratave.

Në themel të kësaj qasjeje qëndron një konceptim i gruas, jo si një objekt pasiv i dhunës, por si subjekt aktiv në gjendje për të ndërvepruar, t'i kundërvihet, dhe t'i japë fund kësaj. Operatorët e strehimoreve e njohin gruan si bartëse të njohurive të gjendjes së saj të dhunës dhe nivelit të rrezikut që mund t'i kanoset. Kur në disa raste ka një tendencë nga ana e grave për të nënvlerësuar rrezikun për veten dhe fëmijët e tyre, puna e operatoreve shërben për të bërë së bashku me gratë një analizë reale të situatës.

Gruaja vendoset në qendër të ndërhyrjes së strehimoreve sepse

është subjekti në gjendje për të ditur, më mirë se kushdo tjetër se çfarë është më mirë për veten e saj. Pikërisht për shkak të këtij supozimi operatorët e strehimores nuk do përfitojnë nga njohuri të para-caktuara të cilave gratë do t'iu duhej t'u përshtateshin, por aplikojnë një metodologji të ndërhyrjes që ka si pikë referimi konstante dëshirën dhe nevojat që gruaja shpreh.

1.2.3 Profesionalizëm dhe marrëdhënie midis grave: parimet e ndërhyrjes mbështetëse.

Mirëpritja e grave në strehimore shpesh është momenti i parë i kontaktit, fillimi i raportit. Për këtë arsye, mirëpritja menaxhohet nga ekipi i operatorëve përkatësisht të trajnuar me aftësi të veçanta mbi dhunën e burrave ndaj grave.

Objektivi i parë që operatorja i vë vetes është ndërtimi i një marrëdhënieje mirëbesimi me gruan. Qëllimi është të kërkojë prej saj të hapet që të tregojë, ndoshta për herë të parë, pa druajtje. Në ndërtimin e këtij raporti, është e rëndësishme që gruaja para së gjithash të ndihet e sigurtë dhe e mbrojtur, në një mjedis ku mund të shprehet lirish dhe t'i rielaborojë përvojat e veta të dhunës.

Që të mund të zhvillohet një marrëdhënie besimi, operatorja do ta bazojë punën e saj në dëgjimin e drejtpërdrejtë të fjalës së gruas dhe në një qëndrim jo-gjykses, me qëllimin për të vlerësuar ndjenjat dhe pikëpamjet e saj, duke e njohur atë si një person të besueshëm. Është gjithashtu thelbësore që gruaja të perceptojë qartësisht që është në një ambient të rezervuar, ku çdo gjë që do të thuhet nuk do t'ju komunikohet palëve të treta dhe as vendimet nuk do të merren pa pëlqimin e saj.

Pra duke filluar nga marrëdhëniet mes grave, krahasimi dhe vlerësimi i ndërsjellë, fillon për gruan një rrugë drejt vetëdijes, duke identifikuar aftësitë e tyre. Të japësh zë dhe të njohësh përvojën personale dhe unike të gruas, t'a forcosh atë në zgjedhjet e saj, t'a ndihmosh të rimarrë kontrollin mbi jetën e saj, janë të gjithë mekanizma dhe strategji që operatorja i vë në veprim në mënyrë që të rrisë fuqizimin e gruas që ka përjetuar dhunë.

1.2.4 Procesi i fuqizimit.

Në fazën e parë të rrugës së daljes nga dhuna, vëmendja e shumicës së grave anon drejt nevojave dhe ndjenjave për partnerin e tyre, ndërsa ndaj vetvetes gruaja ushqen ndjesi të rënda faji dhe papërshtatshmërie.

Hapi i parë i rrugës që bëhet nga gruaja së bashku me strehimoren synon t'a zhbëjë këtë perspektivë. Përprjekja e nevojshme nga gruaja është që të mendojë për veten, domethënë rreth asaj se qfarë përjeton dhe si është duke e jetuar marrëdhënien. Një nga qëllimet e kësaj pune është, në fakt, që të shoqërojë gruan në një rrugë që t'a ndihmojë për atribuar, në një rrafsh të drejtë realiteti, përgjegjësinë për dhunën partnerit, vetëdijshëm të vendosë nëse do të vazhdojë dhe të rikontrakttojë me të duke u kthyer në shtëpi, ose të lërë atë përgjithmonë.

Gjatë procesit të fuqizimit operatorja ndihmon gruan t'i njohë dhe t'i shprehë dëshirat dhe nevojat e saj të veçanta. Edhe pse këto të fundit mund të duket të jenë në kundërshtim me njëra-tjetrën (p.sh. dëshira për të ndaluar dhunën kundrejt qëndrimit me partnerin e saj; të mendojë për familjen kundrejt dëshirës për të bërë zgjedhje për veten e saj), gruaja ka nevojë për një hapësirë që t'i emërtojë, t'i dallojë dhe të kuptojë se prej nga burojnë ato. Përgjigjja për disa prej tyre bëhet me hapa të vegjël, përprjekje, mikro-qëllimet që gjatë punës mund të diskutohen përsëri dhe të ndryshohen në atë masë që ndryshon horizonti i gruas në vazhdimin e rrugës së vetëdijësisimit.

Procesi i fuqizimit i adresohet ndihmës për gruan që të rizbulojë fuqinë për të vendosur për veten e saj dhe mbi veten e saj, duke e inkurajuar atë dhe duke i konfirmuar aftësitë e saj si grua për t'u përballur me trajtimin e problemeve dhe çështjeve në një mënyrë autonome dhe të pavarur, në përputhje me situatat objektive të mjedisit të jashtëm. Në këtë mënyrë nxitet kalimi nga ndjesia e fajit paralizuese e marrjes së përgjegjësisive për vetveten blerjes, e cila çon në zgjedhje më shumë vetë-mbrojtëse.

Të vendosësh gruan në kushtet për të dalë përfundimisht nga një marrëdhënie e dhunshme do të thotë gjithashtu të ofrosh përgjigje për nevojat materiale. Shumë shpesh përmbushja e këtyre nevojave mund të jepet vetëm nga strehimorja. Në raste të tjera kërkohet

përfshirja e akterëve të tjerë në rrjet. Procesi i fuqizimit dhe e rimarrjes së autonomisë personale ecën paralelisht me nevojën për të kënaqur nevojat e veçanta, të tilla si ato socio-shëndetësore, mbrojtje për veten e tyre dhe fëmijët e tyre, strehim të pavarur dhe ekonomik-punësues. Gjatë bisedimeve me operatorët e strehimoreve gratë mund të shfrytëzojnë jo vetëm një hapësirë për reflektimin mbi veten dhe marrëdhënien e tyre, por atyre iu bëhen të ditura të drejtat e tyre, informohen për mundësitë e qasjes në shërbimet e ofruara nga agjenci të tjera dhe institucione të pranishme brenda territorit të tyre.

Gjatë gjithë kësaj rruge, nuk i ofrohen gruas zgjedhje të paracaktuara, por kërkohet të ndërtohen me të mundësi që marrin parasysh kontekstin socio-ekonomik dhe kulturor në të cilin gruaja jeton. Kjo qasje rrit efektivitetin e ndërhyrjes, sepse janë gratë si protagoniste ato që vendosin për veten e tyre në bazë të veçantive që i dallojnë. Në mënyrë që i gjithë procesi të jetë i suksesshëm është e nevojshme që operatorja të mbajë një sjellje të hapur, të të dëgjuarit aktiv dhe jo-gjykses, me qëllim rritjen e besimit dhe vetëdijes së gruas që të mos ndihet vetëm. Të kuptuarit e kësaj e ndihmon gruan të mendojë për shtigjet e mundshme për të dalë nga dhuna. Gjatë gjithë procesit operatorja mbetet gjithmonë një hap prapa gruas, ajo nuk e zëvendëson atë në zgjedhjet e saj, nuk e detyron për të ndërmarrë veprime që nuk i përshtaten ose që i ndjen të vështira për t'i vepruar, dhe nuk do të marrë asnjë vendim pa pëlqimin e saj. Me një fjalë, gruaja që ka pësuar dhunë vendoset në qendër. Operatorja e strehimoreve e mbështet atë në procesin e fitimit të vetëdijes. E gjithë puna e fuqizimit përforcohet falë ndërtimit të marrëdhënieve pozitive, solidaritetit dhe besimit mes grave. Brenda strehimoreve, gruaja inkurajohet dhe mbështetet në analizën e përjetimit dhe të emocioneve të saj. Në këtë mënyrë krijohet një model pozitiv i marrëdhënieve ndërmjet grave dhe në të njëjtën kohë rritet vlerësimi i viktimës në vetvete dhe ai në raport me gratë tjera.

Dalja nga dhuna është pra, një rrugë e përbashkët midis grave dhe strehimoreve. Këto strehimore ndajnë idenë sipas së cilës proceset e riintegritetit duhet të ofrojnë paralelisht përgjigje si nevojave të brendshme dhe emocionale, si atyre të jashtme dhe materiale të gruas, duke e vënë të njëjtën në pozitë për të rritur kontrollin mbi jetën e saj.

PJESA E DYTË

Praktikat e mira

2.1 Rëndësia e praktikave të mira.

Aftësia për të kodifikuar punën e tyre dhe për t'a ndërlidhur si një "praktikë të mirë" nuk përmbush të vetmin funksion për të identifikuar veprimet që do të plotësojnë në mënyrë efektive nevojat e përfitueseve (për shembull, gratë që janë viktime të dhunës), por edhe për të krijuar një model të riprodhueshëm në kontekste të ngjashme.

Vlerësimi i praktikave të mira në strehimore dhe përdorimi i tyre efektiv edhe jashtë ("mes vetë qendrave"), bazohet kryesisht në mundësinë për "tjetrin" për të nxjerrë mësim nga përvoja e atyre që janë ballafaquar me probleme të ngjashme përmes shkëmbimit. Duke lehtësuar përhapjen dhe përdorshmërinë e praktikës së saj të mirë një strehimore ka mundësinë që të përfshijë dhe të mbështesë në zgjedhje dhe në aktivitete jo vetëm strehimoret e tjera, por edhe shërbime të tjera dhe agjenci të pranishme në territorin përkatës në një perspektivë të plotësisimit dhe bashkëpunimit.

Puna e përpunimit dhe e prezantimit të praktikave të mira të strehimoreve të KSK-së e paraqitur në këtë publikim është realizuar me qëllimet që:

- Të bëjë më shumë të dukshme nga jashtë punën komplekse që mbështet gratë viktime të dhunës të realizuar nga strehimoret e grave;
- Të nxisë shkëmbimin e përvojave në mes të subjekteve të ndryshme për identifikimin e kriterëve të nevojshme rreth përhapjes së praktikave të eksperimentuara edhe në territore të tjera;
- Të ndajë me subjektet e tjera të rrjetit praktikatat e mira të krijuara dhe metodologjinë e tyre të identifikuar nga strehimorja për arritjen e objektivave. Ndarja së bashku gjithashtu nxit një përfshirje aktive të çdo subjekti, që ai të mund të sigurojë zbatimin e praktikës në territorin përkatës, duke filluar nga mundësitë e veta.

2.2 Praktikët e mira aktive në strehimoretë KSK-së.

Në këtë kontekst, strehimoretë KSK-së kanë identifikuar 7 praktikë të mira, një për çdo qendër. Praktikët e mira janë të përshkruara në brendësi të këtij kapitulli (paragrafet 2.2.1 - 2.2.7). Këtyre iu është shtuar një prezantim i shkurtër i çdo strehimoreje.

Praktikët e mira janë të lidhura me shërbimet aktive në strehimore. Ato i përkasin fushave kryesore të mbështetjes për gratë viktime të dhunës si në vijim: zgjidhje të pavarur të jetesës, udhëzimeve dhe/ose punësimit, monitorim i situatës së grave në distancë kohore prej daljes nga shtëpia e strehimit.

Identifikimi i një strehimi të sigurt dhe të pavarur për gruan (dhe ndoshta fëmijët e saj) është një nga nevojat e para për të cilat strehimoretë duhet të përballen pas mikpritjes. Një banim i pavarur përfaqëson shpesh alternativën e vetme për t'u kthyer në familjen e abuzuesit. Përveç kësaj, ajo përfaqëson një hapësirë personale nga e cila të rifillojë zhvillimin e vet si një subjekt i pavarur. Gruaja është subjekt aktiv në të gjithë procesin e gjetjes së një zgjidhje të banimit. Në bashkëpunim me operatoren, ajo i identifikon kriteret e banimit që përputhen më së miri me nevojat e saj të tilla si siguria dhe afërsia me disa shërbime (të tilla si shkolla për fëmijë, spitali ose vendin e punës).

Përfitimet e fituara nga gruaja që mbërrin në një zgjidhje për strehim të pavarur dhe të sigurt janë të dyfishta. Nga njëra anë, posedimi i një shtëpie të konsideruar si e veta i plotëson nevojat praktike të sigurisë dhe të pavarësisë në organizimin e jetës së vet. Në anën tjetër, kontribuon në mënyrë të rëndësishme në zhvillimin e besimit në aftësitë e veta të menaxhimit, duke rritur e pavarësinë psikologjike dhe emocionale.

Akoma më tepër, ndërtimi i marrëdhënieve të reja, me fqinjët dhe/ose me gratë e tjera në rastin e bashkë-banimit, nxit gruan për të rritur aftësinë e saj për të menaxhuar marrëdhëniet dhe konfliktet, e ndihmon për të ndërtojë një rrjet të ri social dhe të mbështetjet në përkrahjen e ndërsjellë. Duke pasur për të menaxhuar një shtëpi në mënyrë krejtësisht të pavarur, dhe respektimi i rregullave eventuale të bashkëjetesës, rrit në mënyrë të ndjeshme ndjenjën e saj të përgjegjësisë. Fillon një proces i

ri-marrjes së pavarësisë personale, duke filluar me rivendosjen e hapësirave dhe kohës për vete.

Arritja e autonomisë së banimit i jep gruas gjithashtu një ndjenjë të mëtejshme të lirisë, dhe kufizon rishfaqjen e dhunës. Rreziku i rishfaqjes në raste të tilla është më i vogël, gratë janë më pak të prirura të lënë një gjendje sigurie të cilën e kanë nën kontroll për të rënë sërish në dhunë, dhe kjo në masë të madhe e redukton prapësinë e durimit. Një tjetër element thelbësor për riintegrimin e gruas është orientimi dhe qasja në punësim. Pavarësia ekonomike u lejon grave të ndërtojnë një vetëmjaftueshmëri afatgjatë. Në momentin që nis ky proces, gjithmonë me një qasje pjesëmarrëse dhe bashkëpunuese ndërmjet operatores dhe gruas, fillon me identifikimin e aftësive, mundësive dhe aspiratave të gruas së strehuar. Operatorja e ndihmon gruan të kuptojë tregun lokal të punës, duke e këshilluar rreth përdorimit të mjeteve për kërkimin e punës dhe udhëzimet në eksplorimin e akterëve (publikë dhe privatë) të pranishëm në terren që mund të lehtësojnë hyrjen e saj në botën e punës (për shembull, qendra për aftësi profesionale, qendrat e punësimit, kompanitë private, etj.).

Kështu fillon një fazë në të cilën gruaja i rrit njohuritë e elementeve të dobishme për (ri) vendosjen në tregun e punës, duke vështruar drejt mundësive të saj reale. Në kërkimin aktiv të punës, qendrat zakonisht iu drejtohen vetë sektorit publik (nëpërmjet qendrave për punësim), kompanive private, ose e adresojnë gruan pranë OJQ-të tjera që falë programeve të tyre, mbështesin nisjen e bizneseve të vogla.

Duke u nisur nga nevoja për t'iu ofruar mysafireve një mjet që siguron pavarësinë e tyre afatgjatë, qëllimi është të kapërcehen ndikimet ekonomike që dhuna ka pasur mbi viktimën. Vlera e këtij shërbimi nuk qëndron vetëm në gjetjen e një punësimi për të strehuarat, por t'i lejojë ato për të marrë informacionet e duhura për të hyrë, në një mënyrë krejtësisht autonome, në tregun e punës duke ditur të çmojnë dhe të vlerësojnë aftësitë e tyre, duke njohur mjetet që territori ju ofron dhe të dijnë si të lëvizin mes tyre. Një proces i tillë pa dyshim i gjatë dhe kompleks, rrit vetëdijen e gruas mbi veten dhe përparësive dhe mangësive, rrit besimin në vendimet e saj dhe nxit një ripërpunim të përvojave të saj.

Pasi të ketë filluar procesi i autonomisë së banimit dhe punësimit,

gruaja ka rimarrë pak nga pak hapësira të vogla të pavarësisë dhe të vetëbesimit, por përvoja dhe kujtimi i dhunës femërore do të jetë gjithmonë pjesë e gruas, dhe kësaj mund t'i bashkangjiten momente shqetësimi, të cilave prania e qendrës i ndërhysh me përkrahje. Për këtë arsye, strehimoret kanë aktivizuar një shërbim të monitorimit të gruas që del nga qendra. Procesi i monitorimit nis gjithmonë me kërkesë të gruas, qoftë kur kjo vendos të kthehet në familjen e origjinës apo burrit, apo kur ka për qëllim të jetojë në mënyrë të pavarur.

Falë përvojës së drejtpërdrejtë të strehimoreve, është konstatuar se si shërbimi i monitorimit dëshmohej të jetë një mjet i çmuar, i aftë për të mbështetur gruan në një proces të riintegritimit që shumë shpesh dëshmohej tepër kompleks, për të forcuar ndjenjën e sigurisë dhe besimit në vetvete dhe në aftësinë e saj për të rikthyer qetësi më të madhe dhe pavarësi në marrje dhe mbështetje të vendimeve.

Monitorimi i lejon operatorët të kuptojnë përparimin e gruas në rrugën e saj drejt fuqizimit, dinamikën familjare që përjeton, dhe të vlerësojë se si kjo e përballon dhe menaxhon përditshmërinë e re. Përveç kësaj, i mundëson strehimores të ruajë kujtimin e historive të grave, të përjetimit të tyre dhe dinamikat që karakterizojnë dhunën në nuancat e saj. Duke filluar prej trashëgimisë së çmuar që është kujtesa historike e grave të strehuara, qendra mund të vlerësojë punën e saj, të reflektojë mbi dinamikat e dhunës dhe të zhvillimeve të saj, të krahasohet me institucionet mbi dinamikat dhe tendencat e dhunës në territorin e përkatës.

2.2.1 *Procesi i pranimit të grave në strehimore*

*nga Nazife Jonuzi **

Fusha e ndërhyrjes:

Fuqizimi/mbështetja e daljes nga dhuna.

Objektivat:

1. Ristabilizimi i ekuilibrit emocional të gruas.
2. Rritja e vetëdijësimin të gruas për veten si grua.
3. Ripërtërirja dhe përforcimi i besimit të gruas në vetvete dhe në aftësitë e saj

4. Të dëshmuarit dhe të bërit të përjetoj gruas së strehuar të një marrëdhënieje midis grave në bazë të solidaritetit.

Përshkrim i shkurtër i projektit¹⁴

Strehimi i gruas lindë nga urgjenca e sigurimit të saj dhe nga nevoja për të thyer ciklin e dhunës që mbizotëron, me veprim të fortë dhe të menjëhershëm. Nevoja e parë e shprehur nga gruaja në çastin e hyrjes në strehimore, është që të ndihet e sigurt dhe e mbrojtur. Nevoja për pavarësi dhe autonomi, megjithatë, është rezultat i një procesi gradual të kompletuar nga gruaja gjatë qëndrimit të saj në shtëpi. Për të lehtësuar këtë proces, stafi i shtëpisë së strehimit, i thekson gruas se strehimi në shtëpi përfaqëson një moment kalimtar dhe mbështetës në rrugën drejt pavarësisë. Në fakt, vetëm në raste të jashtëzakonshme, pranohet të strehohen gra për më shumë se 6 muaj. Besohet se një grua nuk duhet t'a perceptojë kurrë strehimoren si një zgjidhje përfundimtare të banimit, sepse kjo do t'i ndalonte asaj që të marrë përgjegjësinë e plotë për jetën e vet.

Praktika të standardizuara dhe mjetet e përdorura

Intervistë fillestare me menaxheren e caktuar gruas.

Intervista synon të identifikojë paraprakisht gjendjen e grave dhe të përcaktojë shkallën e rrezikut (një divorc, një padi e paraqitur në gjykatë ose të ngjashme). Pas dëgjimit të historisë së gruas, identifikimit të kuadrit të saj të arsimit dhe traumave të përjetuara, ajo ftohet që të ketë një takim me psikologun.

Intervista me psikologun. Psikologjia thëllon dialogun me gruan dhe integron informacionin paraprak të dhënë nga ajo.

Takim me menaxheren e rastit dhe psikologun.. Menaxherja e rastit dhe psikologjia ballafaqohen mbi rastin dhe zhvillojnë një strategji të përbashkët në marrëdhënien me gruan që do të ndahet më pas me të njëjtën.

Vazhdimi i marrëdhënies me gruan. Një herë e përfunduar faza paraprake, takimet me gruan menaxhohen pastaj nga psikologjia e

¹⁴ Procedurat brenda strehimores varen nga donatorët e jashtëm, aktualisht strehimorja arrijë të sigurojë strehim falë fondeve publike komunale (banimin dhe shërbimet, veshmbathjen dhe ushqimin për gratë). Në momentin kur këto të mbarojnë, strehimorja do të siguronte vetëm shërbimet e pritjes por jo edhe ato të mikëpritjes

cila mban një ballafaqim të përditshëm me menaxheren e rastit. Psikologjia menaxhon takimet në dy nivele: një individuale dhe një grupore. Fillimisht, takime individuale mbahen 3-4 herë në javë. Nga momenti që gruaja fillon të hapet, si ndaj grave të tjera të qendrës, ashtu edhe ndaj botës së jashtme, takimet javore zvogëlohen në 2, prej të cilave njëri individual. Në takimet grupore trajtohen tema të lidhura me përvojat e përbashkëta, dhe vetë psikologjia hyn në lojë duke vendosur në tryezë përvojat e veta familjare dhe problemet e saj. Temat e diskutimit udhëhiqen nga vetë gratë që me radhë pajtohen mbi zhvillimin e një teme të caktuar.

Pikat e forta dhe të suksesit:

- Ndjenja e fortë e solidaritetit dhe e bashkëpunimit midis anëtarëve të stafit, mundëson që t'i transmetohet gruas besimi dhe qetësia gjatë gjithë udhëtimit të saj drejt vetëdijes.
- Marrëdhëniet e vendosura ndërmjet operatoreve iu tregojnë grave jo vetëm një shembull të një marrëdhënie të shëndetshme dhe solidare femërore, por edhe se si kjo mund të jetë një mjet i dobishëm për të kapërcyer vështirësitë.

Pikat e brendshme kritike:

- Asnjë.

Pikat e jashtme kritike:

- Edhe pse marrëdhëniet e mira me institucionet iu garantojnë strehimoreve që të mund të përqëndrohen në punën e tyre të brendshme, ato perceptohen si lehtë të ndryshueshme, varësisht nga politika aktuale.

Vështirësitë eventuale në transferueshmërinë në zona të tjera të vendit:

- Asnjë, por është e nevojshme të krijohet në mënyrë paraprake një harmoni e theksuar midis operatoreve të strehimores.

* *Drejtoreshë e Qendrës për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve "LIRIA" në Gjilan*



Liria
GJILAN

Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin
e Grave dhe Fëmijëve
Center for Protection and Rehabilitation
of women and Children
0280 / 325-900, 325 700
044 / 135-729
liriagjilan10@hotmail.com

"LIRIA"

Qendra për mbrojtjen dhe rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve "LIRIA", Gjilan

Misioni Mbrojtja, mbështetja dhe promovimi i të drejtave të grave në gjithë Kosovën, zhvillimi i mirëkuptimit, tolerancës dhe frymës së bashkëpunimit për arritjen e plotë të mirëqenies së grave.

Shtëpia e strehimit për gratë dhe fëmijët që kanë përjetuar dhunë në familje nuk bën asnjë dallim të përkatësisë etnike, moshës, gjinisë, kombësisë, fesë, nivelit të arsimit, orientimit politik dhe seksual.

Shërbime

- Akomodim i sigurtë dhe i rehatshëm;
- Ushqim dhe veshmbathje;
- Kujdes mjekësor dhe seanca të edukimit shëndetësor;
- Këshillim psikologjik dhe ligjor;
- Aktivitete psiko-sociale;
- Ndërmjetësim dhe këshillim familjar;
- Kurse bazike profesionale;
- Aktivitete edukuese;
- Seanca ndërgjegjësimi, përgjegjësimi dhe aktivitete rekreative.

Kontakte:

Rruga 28 Nëntori pn Gjilan
Tel: +381 280 325 700; mob: +377 44 125 729
E-mail: liriagjilan10@hotmail.com
Facebook: Qendra Gruas Gjilan

.2.2.2 Pavarësia personale: procesi i rehabilitimit të grave viktime të dhunes, perfituese në strehimore.

nga Jubilea Kabashi *

Fusha e ndërhyrjes:

Fuqizimi/mbështetja për daljen nga dhuna.

Objektivat:

1. Rehabilitim fizik në rastet e keqtrajtimit të rëndë fizik.
2. Rritja e vetëdërgjegjësimit në nivel psiko-fizik tek gruaja.
3. Përforcimi i pavarësisë psikologjike të gruas dhe aftësisë për të reaguar ndaj vështirësive të jashtme.
4. Fuqizimi i autonomisë së menaxhimit personal, të punës dhe familjar të gruas.

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Metoda e identifikimit të nevojave të gruas ndodh si në momente formale përmes intervistave individuale, si në mundësitë për dialog jo-formal që e bëjnë atë më pak të frenuar.

Praktika e standartizuar dhe mjetet e përdorura:

Intervista paraprake. Gratë zakonisht janë të shoqëruara në qendër nga institucionet kompetente (policia, punëtorët socialë dhe MV.). Drejtoresha, në bashkëpunim me akterët referues, vlerëson mundësitë për të pranuar rastin dhe për të dokumentet që posedon gruaja (personale apo të lidhura me historinë e saj personale: paditjet ndaj keqtrajtuesit raporte mjekësore, etj). Pranohen vetëm rastet e grave që vullnetarisht vendosin të qëndrojnë në qendër. Gjithmonë në bashkëpunim me institucionet vlerësohet niveli i rrezikut të gruas dhe lloji i dhunës së përjetuar.

Pasi pranohet, gruaja kalon një periudhë të caktuar të reflektimit gjatë së cilës nuk takon as operatorët, as drejtoreshën.

Takimi i parë individual me drejtoreshën bëhet me hyrjen e viktimës në strehimore dhe biseda fillestare zhvillohet po atë ditë ndërsa identifikimi i nevojave dhe kyqja në aktivitete bëhet pas 48 orëve, mbahet pas 48 orëve nga hrja në strehimore dhe ka për

qëllim identifikimin e nevojave të saj në kuptimin e shëndetit psikologjik.

Në përfundim të takimit përgatitet një plan i punës. Pas hartimit, të planit të vëmendjes, drejtoresha në bashkëpunim me operatorët e qendrës dhe sidomos me psikologun, merret me realizimin e tij ¹⁷.

Intervista me psikologun. Intervista e parë me psikologun ose psikiatren është e detyrueshme pas fazës së ristabilizimit prej 48 orësh. E njëjta gjë ka për qëllim të përcaktojë dhe të propozojë për gruan një trajtim të duhur shëndetsor dhe psikologjik në harmoni të plotë me dëshirat e saj. Intervistat pasuese, personale midis gruas dhe psikologes janë të caktuara dhe të organizuara me respekt ndaj vullnetit të gruas.

Intervistat e vëmendjes me personelin e strehimores. Pas periudhës së reflektimit, gruas i prezantohet stafi i qendrës, duke i shpjeguar asaj detyrat e secilit dhe të shërbimeve që ofrohen. Viktimes se strehuar i jipet kopja e Rregullores së brendshme të strehimores ku ajo do të bazohet në mos shkeljen e rregullave të shtëpisë. Stafi i qendrës, me ndërrime prej tre turnesh, është në gatishmëri 24 rresht. Gjatë ndërrimit ditor ky është i pranishëm sipas orarit të aktiviteteve të planifikuara. Në ndërrimin e natës është e pranishme një operatore në përkrahje të grave në rast nevojë. Gjatë aktiviteteve ditore stafi është i angazhuar për të furnizuar gratë me ushqime, barna aty ku parashihet nga plani i kujdesit dhe të përmbushin nevojat të tjera. Stafi i qendrës apo vetë gruaja informojnë familjen dhe të afërmit e vendit në të cilin ajo ndodhet.

Ndërmjetësimi me familjen. Duke respektuar vullnetin e gruas, strehimorja aplikon ndërmjetësimin mes gruas dhe familjes së saj të origjinës. Takimet zakonisht mbahen në qendrën për ndihmë sociale.

Fuqizimi. Ngritja e vet-besimit dhe fuqizimit të gruas zhvillohet me anë të kurseve, punëtorive, aktiviteteve edukuese dhe seancave psikologjike të mbajtura nga Stafi i Qendres.

Bisedat me operatorët të jashtëm. Bisedat individuale me personel të jashtëm në qendër, në veçanti me asistentët socialë, vendosen gjithmonë duke respektuar vullnetin e gruas.

17 Direktivat e punës jepen nga drejtoresha e qendrës.

Pikat e forta dhe të suksesit:

- Ndërmjetësimi midis viktimës dhe familjes së origjinës, me qëllimin e rikthimit të gruas në gjirin e kësaj të fundit ose gjetja e zgjidhjeve të pavarura afatgjata.
- Ndërmjetësim me institucionet relevante, me qëllim të identifikimit të zgjidhjeve për të sigurta afatgjata.
- Qendra promovon pavarësinë e gruas në nivel psikologjik në riintegrimin e saj social.

Pikat e brendshme kritike:

- Mungesa e burimeve ekonomike të detyrojnë strehimoren t'i shpesh here vullnetar të stafit.

Pikat e jashtme kritike:

- Mungesa e banesave sociale për viktimat e dhunes ku ato do te pamvarsoheshin nga abuzuesi apo familjet abuzive.
- Papunesia ne Kosove dhe mungesa e vendeve te punes per viktimat e dhunes ben me te veshtire riintegrimin e tyre ne shoqeri.

Vështirësitë eventuale në transferueshmërinë në zona të tjera të vendit:

- Asnjë.

** Drejtoreshë e Qendrës për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve në Prizren*



Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve Prizren

Misioni Misioni i QSGF është të sigurojë strehim për mbrojtjen dhe rehabilitimin e grave dhe fëmijëve viktimë të dhunës në familje në rajonin e Prizrenit dhe më gjerë, nëpërmjet formave të parandalimit, trajtimit, edukimit, avokimit dhe lobimit për të drejtat e grave dhe fëmijëve që kanë përjetuar dhunë.

Shërbime

- Akomodim, mbrojtje, trajnim dhe rehabilitim i viktimave të dhunës në familje nëpërmjet programeve psiko-sociale.
- Përforcimi dhe zhvillimi i aftësive të viktimave nëpërmjet punëtorëve dhe kurseve të trajnimit.
- Riintegrimi i viktimave të dhunës në familje dhe shoqëri.

Kontakte:

Marin Barleti Nr.4/20000 Prizren
Tel: 029/234 794; 044/380 345
E-mail: qsgf_pz@hotmail.com;
jubilea.k@hotmail.com.

2.2.3 Pavarësia e punësimit: arritja e një jetese të pavarur përmes punës.

nga Naime Sherifi *

Fusha e intervenimit:

Pavarësia e punësimit/ekonomike.

Objektivat:

1. Rritja e vetëdijes tek gruaja mbi vetveten.
2. Përforcimi i autonomisë vendimmarrëse të gruas.
3. Mbështetja konkrete për gruan gjatë procesit të riintegritimit social.

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Shumica e grave që strehohen në strehimore kërkon mbështetje të vazhdueshme, jo vetëm gjatë qëndrimit të tyre, por edhe në fazën e kthimit në shoqëri. Disa gra vendosin të rikthehen në familjen e origjinës, të tjerat në familjen e burrit, dhe të tjera të jetojnë vetëm dhe të ndërtojnë jetën e vet të pavarur. Pavarësisht zgjidhjes që vendosin, të gjitha gratë kanë nevojë të përkrahen në gjetjen e punës. Në këtë aspekt, stafi i bashkangjitet gruas në eksplorimin e mundësive të saj për punësim dhe orientimit në tregun e punës.

Gruaja këshillohet duke marrë parasysh përvojat e saj, aftësitë, kompetencat dhe i adresohet agjencive për mbështetje në punësim të pranishme në Kosovë. Ajo gjithashtu informohet mbi të gjitha mekanizmat ligjorë dhe socialë që mund t'a ndihmojnë në gjetjen e punës.

Pas fazës së identifikimit të aftësive të saj, gruaja mbështetet në qasjen ndaj tregut të punës, veçanërisht në identifikimin e kanaleve të kërkimeve lokale dhe iu drejtohet agjencive të punësimit,

institucioneve dhe individëve. Një mekanizëm tjetër i rëndësishëm kërkimi janë OJQ-të që punojnë në zonën e Prishtinës, të cilat ndër vite kanë mundësuar dhe aktivizuar mjete mbështetëse për gratë që lënë strehimoren, nëpërmjet financimit të aftësimit profesional dhe fillimin e biznesit të vogël që prodhon të ardhura.

Praktika e standardizuar dhe mjetet e përdorura:

Intervista individuale. Këshillueset punojnë me gratë për t'i identifikuar interesat e tyre, afinitetet dhe aspiratat e karrierës. Më pas hartojnë një plan të kujdesit dhe përcaktojnë kriteret për zbatimin e tij. Plani përfshin qoftë rrugën që gratë ndjekin në qendër, qoftë atë të jashtme te riintegrimi.

Plani i kujdesit për riintegrim. Kur gruaja mbërrin fazën e riintegrimit, plani përditësohet dhe caktohen pikat bazë për riintegrimin e saj.

Trajnimi. Pasi të jenë identifikuar nevojat dhe aspiratat e gruas, asaj i propozohet të marrë pjesë në kurset e trajnimit profesional, përveç kësaj shoqërohet në kërkimin e një pune duke e ndihmuar për të arritur: një aftësi të mirë të shqyrtimit dhe hartimit të Curriculum Vitae të saj; një kuptueshmëri të plotë të kanaleve ekzistuese të kërkimit të punës; një ndërgjegjësim i mjaftueshëm për rreziqet dhe sigurinë në vendin e punës.

Procesi i riintegrimit jashtë qendrës. Me pëlqimin e gruas që ka dalë nga strehimorja, punëtorët e qendrës e mbështesin në mënyrë të vazhdueshme atë përmes takimeve të monitorimit. Gjatë këtyre takimeve diskutohet rruga e ndërmarrë dhe monitorohet gjendja familjare kur gruaja ka vendosur për t'u rikthyer aty. Në raste të veçanta, gruaja merr mbështetje edhe për veshje, ushqim, shërbime gjinekologjike. Pas një periudhe të caktuar, punëtorët vlerësojnë mundësinë për të vijuar apo jo aktivitetin e monitorimit.

Si gjatë qëndrimit në qendër ashtu edhe në fazën e riintegrimit, gruas i garantohet konfidencialiteti mbi rastin dhe siguria personale.

Pikat e forta dhe të suksesit:

- Kontakt i vazhdueshëm dhe konstant i qendrës me gruan.
- Lobim institucional për mbështetjen ndaj grave viktime të dhunës në fazën e riintegritimit.
- Ndërmjetësim midis gruas dhe familjes së origjinës.
- Ndërmjetësim midis gruas dhe familjes së keqtrajtuesit, me qëllim që të zgjerohen të mirat e jetesës për gruan.
- Vlerësim konstant i punës së bërë nga strehimorja në mbështetje të gruas.

Pikat e brendshme kritike:

- Shpenzimet e larta të lidhura me monitorimin (lëvizjet e stafit, mjetet e nevojshme për monitorimin), bëjnë që në shumë raste ky aktivitet të bëhet vullnetarisht nga ana e stafit.
- Numri i vogël i personelit në gatishmëri për aktivitetet e monitorimit.
- Ngarkesë e madhe e punës.

Pikat e jashtme kritike:

- Rritja e papunësisë dhe mungesa e vendeve të sigurta për gruan.
- Mungesa e donacioneve për fazën e riintegritimit.
- Kërcënime fizike nga ana e familjarëve të viktimës.

Vështirësitë eventuale në transferueshmërinë në zona të tjera të vendit:

- Asnjë.

** Drejtoreshë e Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Prishtinë*



Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Prishtinë

Misioni Misioni i Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF) është të përmirësojë të drejtat njerëzore të gruas dhe fëmijës në të gjitha sferat e jetës dhe t'i mbrojë, duke iu ofruar atyre ndihmë të drejtpërdrejtë për mirëqenien e tyre fizike dhe psikologjike, përfshirë këtu sigurinë personale. Misioni i saj është gjithashtu për të bërë avokim për të drejtat njerëzore të grave dhe fëmijëve, të luftojë për mundësi të barabarta të gruas në procesin e vendimmarrjes demokratike në vend.

Shërbimet Qendra QMGF ka kapacitet për të akomoduar 16-19 viktima. Viktimave iu ofrohet siguria fizike dhe shërbime për kohën e nevojshme të rehabilitimit të plotë të tyre. Viktimat mund të strehohen në qendër për një periudhë që lëvizë nga 1 në 6 muaj, në varësi të nevojës. Në qendër ofrohen gjithashtu shërbimet e riintegrit, punëtori rrobaqepsie dhe punëdore, kurse të kompjuterave, shërbim të internetit, kurse të gjuhës angleze, zhvillim i arteve të aplikuara, palestër dhe gjimnastikë.

Kontakte:

Adresa: Lagjia Ulpiana, rr. Imzot Nikë Prela, 45, Prishtinë

Tel&Fax: 00 381 (0) 38 54 54 76

Mob: 00 377 (0) 44 50 80 81

E-mail: cpwcprishtina@yahoo.com

Web-site: www.cpwc-qmgf.org

Mobil : +377 (0) 44 508 081

E-mail: naime_sherifi@yahoo.com

2.2.4 Pavarësia e banimit: mbështetja ndaj gruas në rrugën e riintegrit social.

nga Sakibe Doli *

Fushat e intervenimit:

Pavarësia e banimit

Objektivat:

1. Mbështetje gruas në arritjen e pavarësisë personale dhe menaxheriale të shtëpisë.
2. Përforcimi i vetëbesimit të gruas.
3. Të favorizojë marrjen e një roli aktiv nga ana e gruas, gjatë rrugëndaljes nga dhuna.

Përshkrim i shkurtër i procesit:

"Shtëpia e Sigurtë" është një strehimore e vendosur në Gjakovë, për gratë që përjetojnë dhunë. Qendra është e tipit të hapur, kjo i lejon gruas që të plotësojë nevojën e mikpritjes në siguri dhe në të njëjtën kohë të fillojë një proces punësimi qysh gjatë qëndrimit të saj në këtë shtëpi. Gjatë periudhës së strehimit punëtorët punojnë me gruan për t'a ndihmuar të rifitojë besimin në vetvete, duke e shoqëruar atë në një proces të fuqizimit në pritje të daljes nga shtëpia e strehimit. Kur gruaja rifiton pavarësinë e saj dhe në marrëveshje me punëtorët konsiderohet e gatshme për riintegrim, shtëpia e strehimit ndërmer hapat e parë për t'a mbështetur atë në gjetjen e një akomodimi.

Praktika e standardizuar dhe mjetet e përdorura:

Nevoja për banim e gruas. Si hap i parë gruaja dhe punëtorët reflektojnë së bashku mbi llojin e shtëpisë që mund të plotësojë nevojat e saj duke marrë parasysh praninë ose mungesën e bijve dhe bijave. Akomodimi zakonisht kërkohet në zonën e Gjakovës, mirëpo kur niveli i rrezikut për gratë është i lartë ai kërkohet në zona tjera.

Kërkimi i shtëpisë. Bëhet duke iu drejtuar agjencive të patundshmërive dhe nëpërmjet angazhimit personal të punëtoreve dhe vetë gruas.

Pas identifikimit të një liste të shtëpive të mundshme, stafi i qendrës kryen një kontroll mbi pronarët nëpërmjet bisedave informative. Nëse pronari konsiderohet i besueshëm, vihet në kontakt me gruan. Nëse takimet kanë karakter pozitiv, palët nënshkruajnë kontratën me mbështetjen e qendrës.

Qëndrimi në shtëpi. Pas nënshkrimit të kontratës¹⁶, gruaja përcakton me strehimoren një kod sjelljeje për shfrytëzimin e shtëpisë, i cili është i vlefshëm për gjithë kohëzgjatjen e mbështetjes për pagesën e qirasë, dhe është i bazuar në rregullat e mëposhtme:

Ndalim i hyrjes në shtëpi për burrat, përfshirë familjarët.

Ndalim i konfliktit në menaxhimin e shtëpisë, i vlefshëm si për rastin e bashkë-banimit, ashtu edhe në rastin e gruas me fëmijë. Atëherë kur gruaja nuk do të jetë në gjendje të menaxhojë një konflikt eventual, mund të llogarisë në mbështetjen e punëtoreve të qendrës për zgjidhjen e tij. Gjithsesi kur vazhdohet një sjellje jo korrekte, ajo mund të largohet prej shtëpisë.

- Gatishmëri, në rastin e bashkë-banimit, për mbështetje të ndërsjellë në kujdesin ndaj fëmijëve (kur nënat janë në punë).
- Detyrim për pastrimin e shtëpisë.
- Detyrim në pjesëmarrje të shpenzimeve të përbashkëta shtëpiake.

18 Strehimorja mbështetë pagesën e qarasë dhe të energjisë elektrike për 1 ose maksimum 2 vite, ndërsa të gjitha shpenzimet tjera mbeten në obligim të gruas.

Pikat e forta dhe të suksesit:

- Rifitimi nga ana e gruas e identitetit të saj dhe e pavarësisë vendimmarrëse qoftë në menaxhimin e përditshmërisë dhe të mirave materiale të saj qoftë në edukimin e fëmijëve.
- Zvogëlim i episodeve të mëtejshme të dhunës (edhe sikur një grua të kthehej tek keqtrajtuesi, pavarësia e përfitur do t'a bënte atë më pak të ekspozuar ndaj abuzimeve dhe më pak toleruese ndaj dhunës).

Pikat e brendshme kritike:

- Vlerësim i gabuar në besimin se gruaja është e gatshme t'a lërë strehimoren dhe si pasojë vlerësim i gabuar i nevojave të saj.
- Gruaja deklarohej jo e gatshme të jetojë vetëm dhe kërkon të qëndrojë në strehimore pavarësisht se aktiviteti i këshillimit mund të ketë përfunduar pozitivisht.
- Vështirësi nga ana e strehimores në mbështetjen ndaj gruas që refuzon të largohet prej saj, pikërisht sepse vetë qendra varet prej donatorëve të jashtëm.

Pikat kritike të jashtme:

- Banesa të papërshtatshme në treg (në zona të rrezikshme për gratë).
- Mungesë e donatorëve.
- Qira e banimit veçanërisht e lartë dhe e papërbalueshme për qendrën.

Vështirësitë eventuale në transferueshmërinë në zona të tjera të vendit:

- Asnjë.

** Drejtoreshë e Shtëpia e Sigurt në Gjakovë*



Shtëpia e Sigurtë Gjakovë

Misioni “Shtëpia e Sigurtë” është një strehimore e tipit të hapur për gra dhe fëmijë viktime të dhunës në familje. Qendra kontribuon në parandalimin e dhunës në familje përmes programeve edukuese, të rritjes profesionale dhe të ndërgjegjësimit psiko-social, ligjor dhe shëndetësor. Ndhmon gjithashtu krijimin e një ambienti për promovimin e të drejtave të grave dhe të frymës së bashkëpunimit për arritjen e mirëqenies së plotë të grave.

Shërbimet

- Edukim dhe ndërgjegjësim i të rinjve, i komunitetit dhe institucioneve mbi dhunën në familje;
- Shërbime të mikpritjes dhe strehimit, këshillimit dhe mbështetje ndaj grave viktime të dhunës;
- Mbështetje përmes linjës SOS 24 orë aktive;
- Monitorim dhe ndërgjegjësim i shoqërisë civile mbi të drejtat e njeriut;
- Lobim për mbrojtjen dhe mbështetjen ndaj grave viktime të dhunës në institucionet lokale;
- Zhvillim i aftësive profesionale të stafit.

Kontakte:

Gjergj Fishta pn
Tel: 0390-330-098
Fax: 0390-328163
E-mail: linjajuaj@hotmail.com

2.2.5 Proceset e punësimit të gruas.

nga *Emine Kabashi **

Fusha e intervenimit:

Pavarësia e punës/ekonomike.

Objektivat:

1. Lehtësimi i arritjes së pavarësisë ekonomike të gruas.
2. Rritja e vetëdijes tek gruaja dhe pikave të saj të forta.
3. Mbështetja për gruan në përfitim të punës dhe në kërkimin e punës.

Përshkrim i shkurtër i projektit.

Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës “Raba Voca”- në Mitrovicë/Mitrovica, është një shtëpi e strehimit e tipit të mbyllur, në të cilën gratë mund të ndër marrin një rrugë për arritjen e pavarësisë së tyre personale në pritje të një jetese të pavarur. Nevoja e pavarësisë së punës, dmth ajo ekonomike, është veçanërisht e ndjerë prej gruas, e cila, përmes një rruge drejt autonomisë të mbështetur nga qendra analizohet aftësitë e saj në aspektin e ngritjes profesionale dhe burimet ekzistuese në botën e punës.

Praktika e standardizuar dhe mjetet e përdorura:

Vlerësimi i rastit dhe i nevojave të gruas. Njëpërmjet intervistave informuese, mbështetëse dhe analizës së mundësive të saj, punëtorët dhe gruaja së bashku shqyrtojnë programet dhe aktivitetet e trajnimit aktiv në strehimore.

Krijimi i një plani të bashkëpunimit me gruan dhe hartimi i Curriculum Vitae-s së saj.

Kërkimi i punës. Punëtorët e strehimores dërgojnë Curriculum Vitae-n e gruas në qendër të orientimit për punësim dhe pastaj kontaktojnë përfaqësuesit e kompanive që ofrojnë punë¹⁹.

19 Qendra e informon në mënyrë konfidenciale punëdhënësin rreth historisë së gruas.

Punësimi në strukturat e identifikuar²⁰: kontrata nënshkruhet fillimisht midis qendrës së orientimit për punësim, strehimore dhe gruas.

Pikat e forta dhe të suksesit:

- Punë e fuqizimit që vijon gjatë gjithë procesit të punësimit.
- Kostoja e ulët për qendrën.
- Orientim në botën e punës në fazën e riintegrit.
- Përfitim nga ana e gruas të një vetëbesimi dhe liri lëvizjeje më të madhe.

Pikat e brendshme kritike:

- Staf i kufizuar në numër me aftësi të paktë për të ndjekur një rast në mënyrë të vazhduar.
- Mungesë e një rrjeti të qëndrueshëm të kontakteve në botën e punës.
- Për sa i përket sektorit privat, ka patur më shumë sukses kur është mundur të llogaritet në donatorët ndërkombëtarë që kanë financuar 50% të pagës për një periudhë të caktuar, duke lënë pjesën tjetër prej 50% për punëdhënësin. Në mungesë të donatorëve, procedurat e riintegritit kufizohen në kurse brenda qendrës dhe në praktika ndërmjetësimi me punëdhënësit të mundshëm.

Pikat e jashtme kritike:


- Shkallë shumë e lartë e papunësisë.

Vështirësitë eventuale në transferueshmërinë në zona të tjera të vendit:

- Asnjë.

** Drejtoreshë e Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “RABA VOCA” në Mitrovicë*

20 Qendra identifikon strukturat punuese pranuese për gratë përmes qendrës për orientim profesional, njohjeve private kryesisht të drejtoreshës, dhe kërkimeve të përgjithshme për vende pune në qytet, megjithatë nuk ekziston një rrjet i caktuar.



Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës “Raba Voca” Mitrovicë

Misioni Është të rrisë dhe të mbrojë të drejtat njerëzore të grave dhe fëmijëve, t'i mbrojë dhe t'u ofrojë ndihmë direkte për të siguruar mirëqenien e tyre psiko-fizike dhe sigurinë personale, të mbushë boshllëqet me të cilat shteti nuk është në gjendje të merret dhe të punojë për arritjen e barazisë gjinore në proceset e vendimmarrjes si pjesë thelbësore e procesit të demokratizimit. Shtëpia e strehimit për gratë dhe fëmijët që kanë vuajtur dhunën në familje është shumë-etnike dhe nuk bën asnjë dallim të përkatësisë etnike, gjinisë (fëmijët meshkuj strehohen vetëm deri në 12 vjet), kombësisë, fesë, etj.

Shërbimet

- Monitorim i të drejtave të grave dhe fëmijëve;
- Këshillim;
- Mbështetje psikologjike dhe sociale ;
- Mikpritje dhe strehim ;
- Ndihmë mjekësore dhe edukim seksual;
- Aktivitete rekreative, ushtrime fizike;
- Mbrojtje dhe këshillim ligjor dhe social;
- Trajnim profesional;
- Riintegrim në jetën familjare dhe shoqërore.

Kontakte:

Dis. Ilirinda, Rr. Ramadan Peci 12, Mitrovicë- Kosovo/ 4000

Tel.: +381 (0) 28 53 43 51,

Cell.: +377 44 273 818 / +377 44 158 686

E-mail: cpwcmitrovica@yahoo.com

E-mail: ekabashi10@hotmail.com

Facebook: Center for Protection of Women and Children Raba Voca.

Website: <http://rabavoca.comuv.com/>

2.2.6 Pavarësia ekonomike: rruga e orientimit drejt punës dhe punësimit.

*nga Hamijet Dedolli **

Fusha e intervenimit:

Pavarësia e punës/ekonomike.

Objektivat:

1. Të inkurajojë rehabilitimin dhe rimëkëmbjen e gruas nga traumat e shkaktuara prej trafikimit.
2. Të rikthejë vetëbesimin e gruas, të përforcojë aftësitë e saj vendimmarrëse dhe t'a përgatisë atë të kthehet një jetë në komunitet pa dhunë.
3. Të identifikojë shërbimet ekzistuese në territor për aftësimin profesional dhe analizën e tregut të punës.
4. Të identifikojë aftësitë dhe nevojat e gruas me qëllim që kjo të mund të zgjedhë trajnime profesionale të përshtatshme dhe që lehtësojnë emancipimin socio-ekonomik.
5. të mbështesë gruan në kërkimin e një pune dhe në arritjen e pavarësisë ekonomike.

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Programi i ri-integrimit i MVPT nuk i adresohet vetëm grave mysafire në strehimore, por edhe atyre që kanë përfunduar fazën e rehabilitimit dhe tashmë janë kthyer në familjet e tyre apo kanë filluar një jetë të pavarur. Riintegrimi i kompletuar i përfitueseve përfshin të gjitha shërbimet e ofruara në fazën e rehabilitimit për sa kohë që ato nuk do të ndjehen më të forta dhe në gjendje për të përmbushur nevojat e tyre. Çdo viktimë e trafikimit duhet të trajtohet individualisht, duke marrë parasysh aftësitë dhe karakteristikat specifike të secilës grua. Në këtë drejtim vlen të përmendet se MVPT që nga viti 2005 ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ka themeluar një sistem të bashkëpunimit me Qendrat Rajonale për Punësim, Zyrrat Komunale për Punësim, Qendrat Rajonale për Aftësim Profesional (QAP) dhe Qendrat për Punë

Sociale (QPS), të cilat janë në kuadër të MPMS-së. Në bazë të një bashkëpunimi të tillë, deri tani përfitueset e MVPT kanë qenë gjithmonë të trajtuara me prioritet në QAP, por jo në QPS për shkak të shkallës së lartë të papunësisë në Kosovë.

Praktika e standardizuar dhe mjetet e përdorura:

Programi i rehabilitimit. Brenda Qendrës së Rehabilitimit, stafi e ndihmon gruan të përmbushë nevojat e saj duke zhvilluar potencialin e saj. Qendra gjithashtu ofron shërbime të kujdesit bazik dhe specifik mjekësor, këshillim psikologjik individual dhe në grup, këshillim ligjor, trajnim edukues dhe profesional për zhvillimin e aftësive, seanca për ngritje të vetëdijes me qëllim të parandalimit të rritafikimit dhe seanca mbi fuqizimin me qëllim që ta përgatisin atë për punën më të përshtatshme në bazë të potencialeve të shprehura nga gruaja.

Plani i riintegrit, hartohet nga gruaja së bashku me punëtorët pas fazës së rimëkëmbjes, nëse gruaja ndjehet mjaftueshëm e fortë për të përballuar ndryshimin. Në planin e riintegritit përcaktohen nevojat e saj, aftësitë dhe dëshirat, duke planifikuar hapat e mëtejshme.

Aftësimi profesional. Gruaja inkurajohet të regjistrohet në trajnimet profesionale të organizuara jashtë Qendrës së Rehabilitimit. Në përputhje me dëshirat dhe vullnetin e saj, MVPT dërgon gruan në Qendrat/Zyrat e Punës, të cilat veprojnë në nivel lokal dhe rajonal, për diskutime, këshillime dhe seanca orientuese mbi punën. Në bazë të aftësive të saj, gruaja këshillohet mbi trajnimet profesionale pa pagesë pranë Qendrave të Trajnimit Rajonal/Aftësimit Profesional. Në mungesë të mundësive trajnuese të përshtatshme, ajo adresohet në sektorin privat. Pas përfundimit të trajnimit, gruaja ndihmohet nga stafi i MVPT-së dhe Qendrat/Zyrat e punësimit për kërkim të punës.

Kërkimi i punës me mbështetjen e punëtores. Në fazën fillestare të kërkimit aktiv dhe të mirëfilltë, gruaja ndjek disa seanca informuese

në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore dhe kurseve të informimit/trajnim të bazuara në menaxhimin e burimeve të saj financiare, mbi hapjen e një llogarie bankare, mbi gjithçka tjetër që mund të jetë e dobishme për një jetë të pavarur. Si hap i dytë punëtorja dhe gruaja bëjnë së bashku një analizë të nevojave, dëshirave dhe mundësive të kësaj të fundit, i analizojnë mundësitë reale të tregut lokal, zhvillojnë një plan riintegrimi duke projektuar hapat pasardhës.

Orientimi në punë dhe trajnim. Gruaja shoqërohet dhe mbështetet në hartimin e një Curriculum Vitae si mjet i vetë-njohjes.

Kërkimi aktiv i punës nëpërmjet dy procedurave të ndryshme: duke iu drejtuar Qendrës për Punësim ose rrjetit të kompanive private. Në rastin e parë, emri i gruas vendoset në një listë për punësim. Nëse hapet një pozitë e përshtatshme për gruan, MVPT kontakton punëdhënësin potencial për të vlerësuar besueshmërinë e tij. Nëse rezultati është pozitiv, kontrata e punës nënshkruhet nga gruaja dhe nga Qendra. Në këtë rast, paga e gruas detyrohet nga kompania që e punëson. Në rastin e dytë, është stafi i MVPT që kërkon kompanitë e përshtatshme. Kjo zgjidhje kushtëzohet ngushtë me financimet e donatorëve të jashtëm, të cilët mbulojnë pjesërisht pagën që i takon gruas, duke lehtësuar punësimin nga kompania. Edhe në këtë rast kontrata nënshkruhet nga përfituesja, nga MVPT-ja dhe kompania private në fjalë. Në shumicën e rasteve, Qendra i ofron grave subvencione për 3-6 muaj si një stimul. Edhe pse punëdhënësi duhet të vazhdojë kontratën e punës përtej afatit të grantit, kjo shpesh nuk ndodh. Në të dy rastet, përparimi i gruas monitorohet rregullisht për të vlerësuar suksesin.

Pikat e forcës dhe të suksesit:

- Punë e vështirë e përforcimit që shoqëron përfituesen gjatë gjithë procesit të riintegrit.
- Rritja e vetëdijes përmes analizës së burimeve të saj të brendshme dhe pikave të dobësisë.
- Rritja e besimit në vetvete nxitja e përfitimit të pavarësisë.

- Lehtësim i përfitueses në njohjen dhe përdorimin e mjeteve të kërkimit dhe orientimit për punë.
- Në rastet kur kontrata e punësimit ndërpritet, përfituesja gjithsesi do të nxitet të vlerësojë aftësitë e përfituara.
- Bashkëpunim i mirë me palët e treta të interesuara.
- Investime të përmbajtura ekonomike.

Pikat e brendshme kritike:

- Bashkëpunim jostabil me kompanitë private.
- Nevojshmëri kujdesi në identifikimin e kompanive private dhe vendeve të përshtatshme të punës për shkak të veçantive të viktimave të trafikimit.

Pikat e jashtme kritike:


- Shkalla e lartë e papunësisë në vend.
- Trajnim profesional i papërshtatshëm dhe jo i përputhshëm me tregun e punës.
- Prirja, nga ana e kompanive, të pushojnë nga puna përfitueset në përfundim të nxitjes ekonomike të dhënë prej strehimores.
- Vështirësi në gjetjen e punës përmes zyrave të punësimit.
- Nivel i ultë i arsimimit të përfitueseve.
- Mungesa e besimit në aftësitë vetjake për shkak të dinamikave familjare dhe mungesës së përvojës së punës.

Vështirësitë eventuale në transferueshmërinë

në zona të tjera të vendit:

- Asnjë.

** Drejtoreshë e Qendrës për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Prishtinë*



Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore *Prishtinë/Priština*

Misioni Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (MVPT) është një organizatë jo-qeveritare, jo-fitimprurëse dhe e pavarur që merret me shkaqet dhe pasojat e dhunës si pasojë e trafikimit përmes një qasjeje shumëdisciplinare (shërbime sociale ekonomike, vetëdijësim, mbrojtje dhe zbatim të politikës sociale).
MVPT ka për qëllim të lehtësojë procesin e përforcimit të grave dhe të miturve viktimave ose viktimave të mundshme të trafikimit, përmes shërbimeve të ndihmës sociale, parandalimit, edukimit, aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit dhe përgjegjshmërisë, rehabilitimin afatgjatë, trajnimin profesional, aktivitetet rekreative, riintegrimin social, avokimit, informimit.

Shërbimet

- Akomodim i menjëhershëm.
- Rehabilitim.
- Riintegrim afatgjatë.
- Parandalim.
- Rritje e vetëdijes.

Kontakte:

Rr. Pashko Vasa nr.11 A , 10 000 Prishtinë
Tel./fax: 381 38 609 140 ; +377 44 167 395
E-mail: hamijet_dedolli@yahoo.com
Website: www.pvptcenter.net

2.2.7 Monitorimi i gruas në dalje prej strehimores.

nga *Ardita Ramizi Bala* *

Fusha e intervenimit:

Fuqizim/mbështetje për daljen nga dhuna.

Objektivat:

1. Të mbështesë gruan për rikthim në komunitet.
2. Të lehtësojë tek gruaja ndjenjën e sigurisë dhe shoqërimit në procesin e riintegritit social.
3. Të përforcojë besimin e gruas në vetvete dhe në aftësitë e saj.
4. Të rrisë tek gruaja vetëdijen mbi nevojat e saj dhe pavarësinë në marrjen e vendimeve.
5. Të monitorojë ndryshimet e ndodhura në jetën e gruas sa i përket pavarësisë dhe vetëvlerësimit.

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Në çastin kur gruaja është gati të largohet nga shtëpia e sigurt, ajo mund të jetë në një situatë paqëndrueshmërie emocionale dhe materiale. Ndërhyrja e monitorimit është një mjet i dobishëm për të garantuar sigurinë e vetë gruas duke e përforcuar në rrugën e saj të fuqizimit.

Ndërhyrjet e monitorimit zakonisht kryhen në vendin ku banon gruaja. Vizitat në vendbanim iu lejojnë punëtoreve të kuptojnë mjedisin në të cilin gruaja jeton dhe të evidentojnë dinamikat familjare, në rastin e kthimit në familjen keqtrajtuese ose të origjinës. Në rastin kur gruaja zgjedh për një jetë të pavarur, vizitat i lejojnë punëtoret të vlerësojnë se si menaxhon ajo realitetin e saj të ri. Kohëzgjatja e programit të monitorimit është rreth 2-3 vjet pas largimit nga shtëpia e strehimit. Fillimisht, vizitat janë më të shpeshta, mesatarisht 3-4 herë në vit, me kërkesë të vetë gruas, më pas zvogëlohen proporcionalisht me rritjen e sigurisë dhe pavarësisë së saj. Zgjedhja e këtij ritmi kohor është e lidhur me nevojën për t'i

dhënë gruas kohën dhe hapësirën e duhur për të rindërtuar marrëdhëniet dhe jetën e saj, duke shmangur varësinë nga punëtorët e qendrës.

Praktika e standardizuar dhe mjetet e përdorura:

Për sigurinë më të madhe, vizitat në vendbanimin e grave bëhen prej dy punëtorëve të qendrës. Njëra prej tyre është figura që e shoqëroi gruan gjatë procesit të saj të rehabilitimit, kjo mundëson të ruhet dhe forcohet marrëdhënia e besimit e ndërtuar me kalimin e kohës. Mjetet kryesisht të përdorura:

Plani i monitorimit. Hartuar bashkërisht nga gruaja dhe punëtorët në pritje të largimit të saj nga strehimorja, bazohet në vlerësimin e nevojave dhe dëshirave të gruas. Plani përcakton udhëzimet e intervistave individuale në të ardhmen. Në fund të draftimit, punëtorët marrin referenca dhe kontakte të grave dhe i japin të nënshkruajë autorizimin për fillimin e monitorimit.

Intervistat individuale. Punëtorët e strehimores dhe gruaja përcaktojnë nëpërmjet thirrjes telefonike takimet për vizitat. Këto ndodhin në shtëpinë e gruas, ashtu që këshilltarja mund të vërejë gjendjen në të cilën gruaja jeton dhe marrëdhëniet me anëtarët e tjerë të familjes. Punëtorët së bashku me gruan shqyrtojnë nevojat e saj në fazën aktuale të riintegrit. Vazhdimi i marrëdhënies me gruan, i lejon qendrës të mos e ndërpresë mbështetjen mbi disa pika të rëndësishme të riintegrit, të tilla si gjetjen e një pune, arsimimin dhe trajnimin. Gruaja mbështetet edhe për nevoja ngushtësisht materiale: veshje, ushqim dhe kujdes mjekësor.

Vazhdimi i monitorimit. Në përfundim të dy viteve të monitorimit këshillueset dhe gruaja bëjnë një bilanc për të vlerësuar nëse monitorimi është ende i nevojshëm dhe/ose i përshtatshëm.

Pikat e forta dhe të suksesit:

- Vizitat shfrytëzohen nga këshillueset edhe si mjet ndërmjetësues mes gruas dhe familjes përkatëse në raste të situatave konfliktuale.
- Në rast kthimi pranë partnerit abuzues, monitorimi ka pasoja pozitive edhe mbi këtë të fundit, duke nxitur një përballje verbale mes tyre në çift.
- Përforsim i mëtejshëm i punës së fuqizimit.
- Ruajtje e kujtesës historike të grave të strehuara në qendër.

Pikat e brendshme kritike:

- Shpenzime të lidhura me aktivitetin e monitorimit (lëvizjet, detyrimet komunale, etj.), mjete materiale të pakta.
- Kohë e reduktuar për aktivitetet e monitorimit.

Pikat e jashtme kritike:

- Kërcënimet fizike ndaj punëtoreve nga familjarët e gruas.

Vështirësitë eventuale në transferueshmërinë
në zona të tjera të vendit:

- Asnjë.

** Drejtoreshë e Qendrës për Mirëqenien e Grave -
Shtëpia e Sigurtë në Pejë*



Qendra për Mirëqenien e Grave - Shtëpia e Sigurt Pejë

Misioni Mbrojtja, përkrahja dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të grave dhe të vajzave pavarësisht nga orientimi politik, religjioz, niveli i arsimimit, moshë, apo përkatësia etnike, si dhe kultivimi i mirëkuptimit, tolerancës dhe frymës së bashkëpunimit për të arritur barazim e plotë të gruas në shoqëri.

Shtëpia e Sigurt ofron një mjedis të shëndetshëm, vend të sigurt, sigurimin e ushqimit dhe të veshmbathjes, mbështetje psiko-sociale dhe në bashkëpunim me institucionet përkatëse i ofrojmë atyre përkujdesje mjekësore, juridike, trajnime edukative për ngritjen e vetëdijesimit dhe fuqizimit të tyre si dhe aktivitete tjera rekreative.

Kapaciteti i Strehimores është 16 shtretër.

Shërbime

- Akomodim i përkohshëm, mbështetje psiko- sociale, shëndetësore dhe ligjore.
- Ri integrimin afatgjatë familjar dhe shoqëror, vetëdijesimin dhe fuqizimit të tyre.
- Edukim dhe ndërgjegjësim i komunitetit mbi dhunën në baza gjinore dhe barazinë gjinore.
- Bashkëpunim me institucionet përkrahëse për viktima të dhunës

Kontakte:

Peja / Peja - 30000

Tel./Fax: +38 (0) 39 421 398, Mobile: +386 (0) 49 223 543

E-mail: pejawwc@yahoo.com

E-mail: aramizibala@gmail.com

Web: www.qmgks.org

FALËNDERIME

Falënderohen:

Virginia Venneri, Vullnetare Junior e RTM-së në Kosovë, për kujdesin ndaj fazës hulumtuese dhe të draftimit fillestar të doracakut.

Danila Zizi, Koordinatore RTM e Projektit REVIVE, për punën e çmueshme të rishikimit të teksteve dhe vendosmërinë e saj të shquar.

Të gjitha drejtoreshat dhe punëtorët e strehimoreve të KSK-së që ua hapën dyert e qendrave të tyre “italianëve”.

Alessandra Campani, Elisa Bianchi dhe Angela Romanin, Këshilluese dhe Trajnuese të CCAER-it, për entuziazmin dhe profesionalizmin e dhënë në këtë aventurë.

Dragana Stolić, Social Cooperation Section - Operations Section i European Union Office në Kosovë, për mbështetjen vazhdueshme të dhënë gjatë zbatimit të projektit REVIVE.

LISTË E SHKURTESAVE DHE E AKRONIMEVE

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
CCAER	Koordinimi i Qendrave Kundër Dhunës të Emilia Romagna-s
EIDHR	European Instrument for Democracy and Human Rights
KSK	Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës
OJQ	Organizatë jo Qeveritare
REVIVE	Reintegration of Victims of Domestic Violence
RTM	Reggio Terzo Mondo
BE	Bashkimi Evropian
KP	Policia e Kosovës
MPMS	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale.

BIBLIOGRAFIA

- Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ). 2011. Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Aksionit ABGJ: Prishtinë.
- Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ). 2013. Procedurat operative standarde për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë. ABGJ: Prishtinë.
- Associazione Nondasola Donne Insieme Contro la Violenza-Onlus (a cura di). 2012. Dal silenzio alla parola. La violenza sofferta e il desiderio di fermarla. Franco Angeli: Milano.
- Backer Berit. 2003. Behind Stone Walls. Changing household organization among the Albanian of Kosova. Dukagjini Balkan Books: Pejë.
- Campani Alessandra, Romanin Angela. 2012. La violenza da partner nelle relazioni di intimità: l'accesso delle donne alla protezione e alla giustizia. Un pacchetto formativo per chi opera con e all'interno del sistema della giustizia penale.
- Coordinamento dei Centri Antiviolenza della Regione Emilia-Romagna (a cura di). 2012. La rete dei centri antiviolenza rafforza le buone prassi e contrasta la violenza sulle donne. I risultati e le azioni strategiche del coordinamento dei centri antiviolenza della regione Emilia-Romagna. Centro Stampa della Regione Emilia-Romagna: S.l.
- Creazzo Giuditta, Vega Alexandersson Ana Maria. (a cura di). 2012. Sempre più donne scelgono la libertà, affrontano la violenza. I dati dei centri antiviolenza in Emilia-Romagna. Regione Emilia-Romagna: Bologna.
- De Concini Elena (a cura di). 2007. I centri si raccontano. Il lavoro e le esperienze delle Case delle Donne e dei Centri Anti-Violenza dell'Emilia Romagna. S.n.: Rimini.

- Farnsworth Nicole. 2008. Exploratory Research on The Extent of Gender-Based Violence in Kosovo and its Impact on Women's Reproductive Health. Kosovo Women's Network: Prishtinë.
- Farnsworth Nicole, Qosaj-Mustafa Ariana. 2008. Siguria fillon në shtëpi. Hulumtim mbi Informimin e Strategjisë së parë Kombëtare dhe Plani i Aksionit kundër Dhunës në Familje në Kosovë. Agjencia për Barazi Gjinore: Prishtinë.
- Halimi Nexhi. 2011. Women Position and the Environment. Case Study: Kosovo. Mbrojtje e temës së diplomës-master në departamentin e Gjeoshkencave, Universiteti i Uppsala.
- Justice Institute of British Columbia. 2007. Empowerment of Immigrant and Refugee Women Who Are Victims of Violence in Their Intimate Relationships. Final Report. Child, Family and Community Safety Division Justice Institute of British Columbia: New Westminster, BC.
- Qendra e Studimeve Gjinore në Kosovë. 2011. Të drejtat e grave për trashëgiminë mbi pronën në Kosovë. Qendra e Studimeve Gjinore ne Kosovë: S.l.
- Koalicioni i Strehimoreve në Kosovë - KSK. 2011. Programi, strategjia dhe plani i veprimit dhe standardet për strehimoret funksionuese të KSK-së. Prishtinë.
- Agjencia Kosovare e Statistikave. Vëllimi 5: Statistikat Sociale. 2011. Statistikat arsimore 2010 – 2011. Agjencia Kosovare e Statistikave (AKS): Prishtinë.
- Agjencia Kosovare e Statistikave. Vëllimi 5: Statistikat Sociale. 2012. Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomisë Familjare. Agjencia Kosovare e Statistikave (AKS): Prishtinë.
- Agjencia Kosovare e Statistikave. Departamenti i Statistikave Sociale. Sektori i Tregut të Punës. 2013. Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore Kosovë 2012 AKS: Prishtinë.

- Logar Rosa, et. al. 2006. Bridging Gaps-From good Intentions to good cooperation. Manual for effective multi-agency cooperation in tackling domestic violence. WAVE Coordination Office/Austrian Women's Shelter Network: Vienna.
- Logar Rosa, et. al. 2006. Training Manual for Improving Quality Services for Victims of Domestic Violence. Wave Coordination Office/Austrian Women's Shelter Network: Vienna.
- Ministria e Administratës Publike. Vëllimi 5: Statistikat Sociale. 2010. Statistikat arsimore 2009 – 2010. Zyra e Statistikave të Kosovës (ZSK): Prishtinë,
- Ministria e Drejtësisë. Zyra e Koordinatorit Kombëtar kundër Dhunës në Familje. 2013. Aktivitetet kundër Dhunës në Familje. Raporti i Progresit Vjetor, 2012. Prishtinë.
- Organization for Security and Co-operation in Europe-OSCE Mission in Kosovo. (OSCE). Catalogue and advice and assistance for domestic violence victims. S.n.: S.I.
- Payne Darrell., Wermeling Linda. 2009. Domestic Violence and the Female Victim: The Real Reason Women Stay! Journal of Multicultural, Gender and Minority Studies. Volume 3, Issue 1, 2009.
- Plessi Sonja (a cura di). Fempower. Protection & Empowerment. 2/2010 N°18. WAVE office: Vienna.
- Social Impact Research. 2011. Empowering Victims of Domestic Violence. Social Issue Report. Social Impact Research: Boston.
- Zyra e Statistikave të Kosovës (ZSK). 2009. Gratë dhe Burrat në Kosovë. Zyra e Statistikave të Kosovës (ZSK): Prishtinë.
- Talens Cristina, Landman Cecile. 2003. Good Practices on (Re) integration of Victims of Trafficking in Human Beings in six European Countries. BlinN: Netherlands, Change: United Kingdom, Oxfam GB: United Kingdom.

- United Nations. 1995. Beijing Declaration and Platform for Action. Fourth World Conference on Women. Beijing.
- United Nation Development Programme (UNDP). 2012. Kosovo Human Development Report. Private sector and employment. UNDP, Prishtinë.
- United Nations Population Fund (UNFPA). 2005. Gender Based-Violence in Kosovo. A case study. UNFPA: S.l.
- Women against violence Europe (WAVE). 2012. Country report 2012. Reality checks on data collection and European services for women and children survivors of violence. A right for protection and support? WAVE-office/Austrian Women's Shelter Network: Vienna.
- World Bank. 2012. Kosovo: Gender Gaps in Education, Health and Economic Opportunities. World Bank: S.n.
- World Economic Forum. 2013. The Global Gender Gap Report. Insight Report. World Economic Forum: Geneve.

